




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI PËR
SIPËRMARRJEN DHE
KLIMËN E BIZNESIT

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024 – 2030

Tiranë, Dhjetor 2024

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative është zhvilluar me mbështetjen e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) përmes programit të saj Star Venture për Ballkanin Perëndimor, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit për Zhvillimin e Sipërmarrjeve dhe Inovacionit në Ballkanin Perëndimor, dhe nga Luksemburgu përmes Fondit të Ndikimit për Bizneset e Vogla të BERZH-it. Programi mbështet startup-et me potencial të lartë, inkubatorët dhe akseleratorët, duke kontribuar në zhvillimin e ekosistemit të startup-eve në rajon. Pikëpamjet, rekomandimet, dhe strategjitë e shprehura në këtë dokument i përkasin Ministrisë së Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit në Shqipëri dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar apo politikat e BERZH-it ose të palëve të saj të interesit.



PËRMBAJTJA

KONTEKSTI STRATEGJIK	6
Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik	7
Lidhja e strategjisë së zhvillimit të sipërmarrjes inovative me Programin e Qeverisë 2021-2025	7
Lidhja me dokumente strategjike sektoriale dhe ndër-sektoriale	8
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	9
PARATHËNIE E STRATEGJISË	13
DREJT EKOSISTEMIT KOMBËTAR SIPËRMARRËS	15
Marrëdhënia me Kornizën Strategjike Kombëtare dhe të BE-së	15
Vlerat e Përbashkëta të Ekosistemeve Sipërmarrëse	16
Misioni dhe Vizioni i Ekosistemit Sipërmarrës	16
Të Kuptuarit e Ekosistemit të Sipërmarrjes	18
Perspektiva e Inovacionit	18
Perspektiva e aktorëve	18
Elementet e ekosistemit sipërmarrës	22
Shtyllat e Strategjisë së Sipërmarrjes	23
Ekosistem Sipërmarrës Inovativ	24
Sektorët Strategjikë (S3)	25
Zhvillimi Gjithëpërfshirës	26

SITUATA DHE DIAGNOZA	27
Objektivat strategjike	27
Infrastruktura e Inovacionit I fizike dhe virtuale	27
Talenti I zhvillimi, ruajtja dhe tërheqja	30
Investime I përshpejtimi i ciklit të investimeve në Shqipëri	32
Aftësimi për zgjerim I Ngritja e kompanive për zhvillim	34
Sektorët Nxitës	35
Turizmi	35
Agrobiznesi	36
Aktiviteti Prodhues	36
Energjia	36
TIK-u	36
Business Process Outsourcing	36
Nën-sektorë, sektorë	37
Nevojat dhe hendeqet horizontale	38
Sipërmarrja nga gratë	38
Përfshirja e brezave	39
Pabarazia rajonale dhe rurale	40
MASAT PËR KRIJIMIN E NJË EKOSISTEMI TË HAPUR TË SIPËRMARRJES SË INOVACIONIT	41
Masat prioritare	42
Objekti: Krijimi i Agjencisë Shtetërore Start-up Albania	42
Rezultatet	42
Grupet e synuara	43

Niveli Makro	43
Objekti: Ngritja e qeverisjes së ekosistemit dhe koordinimi dhe harmonizimi i angazhimit të palëve të interesuara.....	43
Hartimi dhe diagnostikimi i vazhdueshëm i ekosistemit dhe programet e rritjes	45
Realizimi i aftësisë për zgjerim përmes infrastrukturës së hapur të inovacionit, si fizike ashtu edhe virtuale	45
Qendrat Rajonale të Transformimit dhe Parku Teknologjik.....	46
Ndërtimi i instrumenteve të financimit.....	47
Tërheqja e fondeve ndërkombëtare dhe investitorëve nga diaspora.....	48
Zhvillimi dhe financimi i zgjidhjeve me fokus të gjelbër dhe dixhital në ekonomi	49
Krijimi i një reputacioni ndërkombëtar pozitiv për ekosistemin e sipërmarrjes.....	50
Ngritja e programeve model.....	51
Përmirësimi i politikës për sipërmarrjen dhe talentin e grave dhe vajzave.....	52
Nxitja e sipërmarrjes akademike	52
Talenti, Investimet, Mbështetja e aftësisë për t'u zgjeruar, Masat që lidhen me Qeverinë	53
QEVERISJA E STRATEGJISË.....	55
PLANI I VEPRIMIT.....	57
BUXHETI I NIVELIT TË LARTË DHE MEKANIZMAT FINANCIARE.....	64
VEREJTJE PERFUNDIMTARE.....	65
REFERENCAT	66

KONTEKSTI STRATEGJIK



1. PËRMBLEDHJE DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT STRATEGJIK

Strategjia e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030 u hartua si një dokument politikash afatmesëm i shtrirë në 6 vite, duke qenë në këtë mënyrë në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030. Gjithashtu, strategjia është hartuar në përputhje me dhe kontribuon në realizimin e Axfordës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, e miratuar në vitin 2015 nga Qeveria Shqiptare.

Në këtë dokument strategjik parashikohet në një formë gjithëpërfshirëse vizioni i strategjisë, qëllimet e politikave, dhe masat e nevojshme për arritjen e secilit prioritet, primar dhe sekondar. Në të njëjtën kohë, dokumenti strategjik parashikon edhe treguesit kryesorë të performancës, me qëllim matjen e rezultateve për arritjen e objektivave specifik dhe përmbushjen e qëllimeve të politikave. Për të siguruar arritjen e objektivave specifik, strategjia është shoqëruar me Planin e Veprimit që mbulon të njëjtën periudhë 2024-2030, si edhe parashikon buxhetin e nevojshëm për realizimin e prioriteteve të parashikuara.

Plani i Veprimit është hartuar me qëllim zbërthimin në hollësi të masave që secili institucion duhet të ndërmarrë me synimin final për të arritur objektivat e politikës dhe vizionit të qeverisë shqiptare, në kuadër të zhvillimit të startup-eve dhe ekosistemit të lehtësuesve.

2. LIDHJA E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË SIPËRMARRJES INOVATIVE ME PROGRAMIN E QEVERISË 2021-2025

- Në aspektin e zhvillimit ekonomik, programi qeveritar e vendos theksin tek besimi që qeveria ka tek të rinjtë si forca që do të përshpejtojë progresin drejt Shqipërisë së gjeneratës së dijes. Si rrjedhojë, qëndron angazhimi për të siguruar jo vetëm mundësi më të mira arsimimi në fushat prioritare si shkencat natyrore, teknologji e informacionit dhe inxhinieri, por mundësi reale për të qenë sipërmarrësit e ardhshëm në fushat e inovacionit e teknologjisë, për të konkurruar denjësisht në tregun global.
- Në procesin e krijimit të një ekonomie të fortë, të bazuar në modernizim, produktivitet dhe konkurrueshmëri, Shqipëria shihet si një qëndër rajonale për sipërmarrjet e reja në ekonominë dixhitale, duke siguruar punë dinjitoze për të rinjtë, për të realizuar kështu një kthesë cilësore në punësimin rinor.
- Në procesin e zhvillimit të biznesit të vogël merr edhe më shumë vëmendje sipërmarrja e krijuar nga të rinjtë. Fondi i mbështetjes për sipërmarrjet e reja startup pesëfishohet për të arritur në 10 milionë euro.

3. LIDHJA ME DOKUMENTE STRATEGJIKE SEKTORIALE DHE NDËR-SEKTORIALE

Strategjia e re e Zhvillimit të Investimeve dhe Biznesit (BIDS) 2021- 2027

- » Kjo strategji jep orientimin kryesor të qeverisë shqiptare për zhvillimin ekonomik afatmesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si edhe në investime. Planifikimi i masave për nxitjen e sipërmarrjes dhe inovacionit përfshihet tek *Objektivi Specifik 1.2 'Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni'* i kësaj strategjie.

(i) Rritja e dendësisë së startup-eve nga 88 në 132 (startup-e për një milionë banorë);

(ii) Rritja e vlerësimit në Indeksin e Konkurrueshmërisë Globale (aftësitë inovative) nga 29.8 në 34.

- » **Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm** ka 17 objektiva për zhvillim të qëndrueshëm, të cilat ndërlidhen me politikat dhe planet specifike të Strategjisë në të paktën 15 elementë të këtyre objektivave.
- » **Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin (2023)** synon specifikisht angazhimin e sipërmarrjeve innovative në proceset e bashkëpunimit me strukturat kërkimore shkencore dhe skemat e kërkimit shkencor në Evropë si Horizon Europe, Digital Europe, EUREKA etj.
- » **Agjenda Dixhitale e Shqipërisë 2021 - 2026** thekson zhvillimet në TIK dhe infrastrukturën dixhitale për të mbështetur startup-et. Sipas agjendës dixhitale, qeveria do të shikojë mundësitë për të krijuar mjedise inovatore që mbështesin krijimin e platformave të ndryshme teknologjike që mundësojnë inovacionin dhe rritjen e ekosistemit për bizneset dhe startup-et.
- » **Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025** ka në themel të saj bashkëpunimin me ministrinë përgjegjëse për sipërmarrjen, për afrimin e talenteve shqiptare në botë dhe lidhjen e ekosistemit vendas me atë ku ata banojnë.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Strategjia e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative përbën kuadrin e zhvillimit të ekosistemit shqiptar të sipërmarrjes nga viti 2024-2030, e karakterizon atë, parashikon masat dhe përshkruan veprimet dhe buxhetet e nevojshme. Strategjia është ndërtuar nga Ministri i Sipërmarrjes dhe Klimës së Biznesit dhe Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve, Startup Albania, me mbështetjen e konsulentëve të mundësuar.

Ekosistemi i sipërmarrjes startup në Shqipëri po rritet me shpejtësi dhe po shfaq shenja premtuese zhvillimi. Aktorë të ndryshëm të ekosistemit në Shqipëri kontribuojnë në nxitjen e sipërmarrjes dhe inovacionit nëpërmjet iniciativave të ndryshme, të tilla si krijimi i inkubatorëve të startup-eve, përshpejtuesve dhe hapësirave të bashkëpunimit në qytetet kryesore si Tirana, Korça, Shkoder, etj. Këto iniciativa synojnë të krijojnë një atmosferë të favorshme për rritjen e startup-eve dhe kompanive inovatore. Disa prej kompanive startup kanë fituar tashmë vëmendje në sektorët e teknologjisë, e-commerce dhe fintech.

Në këtë Strategji, ne supozojmë se ndërveprimi midis agjencisë dhe institucioneve përfaqëson ‘hallkën e munguar’ në modelin e rritjes së bazuar në njohuri, i cili përfshin institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore, sipërmarrësit, si dhe akademinë si një burim njohurish të reja. Sa më të forta të jenë institucionet, aq më produktive do të jetë sipërmarrja dhe aq më i madh do të jetë ndikimi i sipërmarrësve në rritjen makroekonomike. Kombinimi i aktorëve të përshkruar dhe ndërveprimi i tyre përfaqëson ekosistemin kombëtar të sipërmarrjes. Për nga natyra e tij, ekosistemi sipërmarrës përfaqëson një formë mjedisi të hapur inovacioni, duke lejuar një rrjedhë njohurish përtej kufijve organizativ të anëtarëve të tij. E ardhmja e sipërmarrjes në Shqipëri mbështetet në aftësinë e ekosistemit sipërmarrës për të shfrytëzuar njohuritë ekonomike dhe për të nxitur një mision afatgjatë kombëtar për të rindërtuar ekonominë gjatë dekadës së ardhshme. Në qendër të kësaj, ekosistemi do të shërbejë për të vënë talentin, aftësitë dhe burimet tona në funksion të transformimit të këtyre njohurive në vlerë ekonomike.

Një ekosistem i tillë i bazuar në njohuri përfshin grupe të shumta aktorësh si dhe një grup kompleks kanalesh dhe instrumentash që synojnë të krijojnë lidhje mes tyre. Strategjia përshkruan natyrën e ekosistemit sipërmarrës nga këndvështrimi i inovacionit shumëstresor dhe të shumëfishtë. Ajo gjithashtu thekson rëndësinë e identifikimit të vlerave të përbashkëta nga aktorët e ekosistemit, si dhe përcaktimin e misionit dhe objektivave të kësaj strategjie.

Deklarata e propozuar e vizionit: **Shqipëria si një ekonomi sipërmarrëse, e qëndrueshme dhe novatore bazuar në inovacion, bashkëpunim proaktiv dhe besim.**

Deklarata e propozuar e misionit: **Rritja e konkurrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë nëpërmjet inovacionit duke ofruar masa të synuara për të zhvilluar një ekosistem të begatë sipërmarrës që inkurajon sipërmarrësit dhe investorët nëpërmjet shërbimeve dhe politikave proaktive.**

Sipërmarrësit, veçanërisht ata në bizneset e vogla dhe fillestare, përjetojnë tensionin e natyrshëm që lind nga kërkesat e partnerëve dhe investorëve të jashtëm për të mbështetur përpjekjet e brendshme për inovacion, ndërkohë që kanë burime të pamjaftueshme për të mbikëqyrur proceset e inovacionit. Duke marrë parasysh rëndësinë e përpjekjeve të koordinuara që përfshijnë aktorë të shumtë, kjo strategji trajton sfidat e hapura të inovacionit nga këndvështrimi i bizneseve startup dhe NVM-ve inovatore në nivelin e biznesit dhe ekosistemit. Ky ekosistem përfshin nivelet mikro, të mesme dhe makro. Niveli mikro përfshin firma dhe organizata individuale. Rrjetet dhe bashkëpunimet e kompanive, duke përfshirë partneritetet dhe bashkëpunimin ndër-organizativ, i përkasin nivelit të mesëm. Së fundmi, niveli makro përfshin faktorë socialë dhe mjedisorë si qeveria dhe politikat.

Strategjia stimulon rritjen e ekosistemit të startup-eve dhe zhvillimin e të gjitha shtresave të ekosistemit, duke përfshirë nivelin mikro, të mesëm dhe makro, dhe gjeneron qarqe të virtutshme brenda ekosistemit dhe sektorëve me prioritet ekonomik në vend. Ajo hedh themelet për transformimin e krijimit të vlerave kombëtare të Shqipërisë, siç e njohim sot, duke trajtuar tre shtylla:



Figura 1. Shtyllat e strategjisë.

Bazuar në shtyllat e përcaktuara, grupi i masave përfshin:

1. **Masat Prioritare**

- » Përmirësimi, konsolidimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startupe-ve dhe Lehtësuesve për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe efektive në realizimin e objektivave ligjore dhe strategjike.
- » Ngritja e qeverisjes së ekosistemit, koordinimi dhe harmonizimi i angazhimit të palëve të interesuara.
- » Mundësimi i aftësisë për rritje përmes infrastrukturës së inovacionit, si fizike ashtu edhe virtuale (Qendrat Rajonale të Transformimit, Parku Teknologjik, platforma dixhitale dhe entitete të tjera të ekosistemit).
- » Ndërtimi i instrumenteve alternative të financimit.
- » Hartëzimi dhe diagnostikimi i vazhdueshëm i ekosistemit dhe programeve të rritjes në çdo fazë.
- » Tërheqja e fondeve ndërkombëtare dhe të diasporës.
- » Ndërtimi i një reputacioni pozitiv ndërkombëtar për ekosistemin e sipërmarrjes.
- » Zhvillimi i skemave nxitëse për angazhimin e kapitalit të korporatës në ndërmarrjet fillestare.
- » Përmirësimi i politikës për sipërmarrjen dhe talentin e grave.
- » Nxitja e sipërmarrjes me burim shkencor.
- » Hartimi dhe nisja e masave për rritjen e numrit të nomadëve dixhital në Shqipëri.
- » Rritje e numrit të zgjidhjeve novatore dhe programeve mbështetëse në sektorin e gjelbër dhe dixhital.

2. **Masat për Zhvillimin e Talentit** – Masa të fokusuara në burimet njerëzore për të përmirësuar zhvillimin dhe mbajtjen e sipërmarrësve të talentuar.

3. **Masat e Financimit Alternativ** – Masa të dedikuara për të ndihmuar në krijimin e mbështetjes financiare të strukturuar dhe efikase për sipërmarrësit.

4. **Masat Mbështetëse të Aftësisë për Rritje** – Mbështetje nga programet e përsheptimit, Qendrat e Inkubacionit, Qendrat Rajonale të Transformimit dhe Parqet Teknologjike.

5. **Masa të Tjera** – Politikat për kompanitë startup në çdo fazë të zhvillimit, mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe implementimin e masave rregullatore në mënyrë efikase.

Grupi i masave të paraqitura shtjellohet më tej përmes planit të veprimit që lidh masat e propozuara me tre faza të ekzekutimit: afatshkurtër 2024-25, afatmesëm 2026-27 dhe afatgjatë 2028-30.

Së fundmi, strategjia paraqet një buxhet paraprak për secilën fazë të ekzekutimit për të gjitha masat prioritare: 6 milionë Euro për fazën e parë 2024-25, 8 milionë Euro për fazën e dytë 2026-27, dhe 10 milionë Euro për fazën e tretë 2028-30.

Në një formë të tillë, ajo përbën një investim madhor në ekosistemin e sipërmarrjes së inovacionit të hapur me përfitime të shumta sociale, financiare dhe makroekonomike. Këto përfitime do të sigurojnë stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit ekonomik kombëtar, duke futur elementë të një ekonomie të bazuar në njohuri.

PARATHËNIE E STRATEGJISË





Gjatë historisë, njerëzimi ka arritur nivele të avancuara që kanë transformuar jetën e përditshme, kanë revolucionarizuar mënyrën e zhvillimit të biznesit dhe kanë rritur produktivitetin, përfshirë këtu shpikjet e motorëve me avull, kompjuterëve dhe inteligjencës artificiale.

Pas këtij transformimi qëndrojnë mendje të ndritura dhe individë gjenialë, të cilët ia dolën mbanë të nxisin këto zhvillime, bazuar në infrastrukturën e biznesit dhe atë sociale. Kombet më të suksesshme përqafuan kulturën e sipërmarrjes, investuan energji dhe burime të jashtëza-

konshme sociale dhe krijuan ekosisteme kombëtare, të cilat mbështetën sipërmarrësit në shtimin e vlerës së produkteve dhe shërbimeve të tyre, si dhe në të qenit novatorë.

Për të shpjeguar ekosistemin sipërmarrës, duhet të kuptojmë institucionet, të cilat krijojnë strukturat nxitëse, ashtu si edhe sipërmarrësit, si aktorë që krijojnë kombinime të reja të faktorëve ekonomikë dhe njohurive. Si rrjedhim, sipërmarrësit ofrojnë mekanizmin e transmetimit për transferimin e përparimeve në njohuri drejt rritjes ekonomike. Me fjalë të tjera, shndërrimi i njohurive të reja dhe ekzistuese në njohuri ekonomike dhe zbatimi i tyre kërkon sipërmarrës.

Në këtë strategji, konsiderohet se ndërveprimi i agjencisë dhe institucioneve përfaqëson “lidhjen e munguar” në modelin e rritjes së bazuar në njohuri, i cili përfshin institucionet e qeverisjes vendore dhe qendrore, sipërmarrësit, si dhe akademinë si burim të njohurive të reja. Sa më të forta të jenë institucionet, aq më produktive do të jetë sipërmarrja dhe aq më i madh do të jetë ndikimi i sipërmarrësve në rritjen makroekonomike¹. Kombinimi i aktorëve të përshkruar dhe ndërveprimi i tyre përfaqëson ekosistemin kombëtar të sipërmarrjes. Për nga natyra e tij, ekosistemi sipërmarrës përfaqëson një formë mjedisi të hapur inovacioni², duke lejuar një rrjedhë njohurish përtej kufijve organizativë të anëtarëve të tij. E ardhmja e sipërmarrjes në Shqipëri mbështetet në aftësinë e ekosistemit sipërmarrës për të shfrytëzuar njohuritë ekonomike dhe për të nxitur një mision afatgjatë kombëtar, me qëllim rindërtimin e ekonomise gjatë dekadës së ardhshme. Në brendësi të kësaj, ekosistemi do të shërbejë për të ndërtuar aftësitë tona, për të përqendruar burimet dhe talentin tonë në dobi të transformimit dhe mënyrës se si krijojmë vlerë ekonomike.

Ekosistemi i sipërmarrjes shqiptare është i vogël në prodhim ekonomik krahasuar me ekonomitë e mëdha si BE-ja, SHBA-ja apo Turqia. Për më tepër, Shqipëria është gjithashtu e vogël në popullsi por, për shkak të kësaj, ajo mund të ofrojë disa avantazhe, siç është lehtësia e rrjetëzimit kur shumica e individëve mund të aksesohen lehtësisht. Ajo është e pasur me lidhje ndërkombëtare përmes lidhjeve të biznesit, rajonit të BE-së dhe diasporës. Rruga e rëndësishme për rritjen e shtrirjes së tregut të sipërmarrësve shqiptarë është nëpërmjet ndërkombëtarizimit të tyre. Prandaj, ekosistemi kombëtar i sipërmarrjes duhet të projektohet për t'u shërbyer sipërmarrësve shqiptarë, duke nxitur aksesin e tyre në tregjet ndërkombëtare, duke rritur vizibilitetin në nivel rajonal dhe duke tërhequr aktorë rajonalë për të kontribuar në zhvillimin e tij.

Si një ekonomi në tranzicion, Shqipëria është e pasur me biznese të reja, pjesa më vitale e ekosistemit të sipërmarrjes. Kjo shtresë ekosistemi kërkon vëmendje të veçantë për shkak të brishtësisë së saj dhe kjo strategji e trajton këtë përmes projektimit të stimujve dhe infrastrukturës.

Nga një këndvështrim social, kjo strategji mbështet një ndryshim në klimën kombëtare të sipërmarrjes. Ajo e trajton sfidën e krijimit të vlerës si një garanci për qëndrueshmëri më të madhe në kriza, duke forcuar kështu rritjen e ekonomisë dhe mirëqenien e qytetarëve. Një qasje e tillë nënkupton një ndërhyrje që motivon dhe angazhon aktorët në të gjithë ekosistemin, një plan që do të ndërtojë infrastrukturë dhe do të sjellë barazi brenda rrjetit social duke përfshirë të gjithë aktorët në të njëjtat kushte. Kjo strategji shqyrton hendekun ekzistues, identifikon zonat kryesore për ndërhyrje dhe propozon një plan të qartë për zhvillimin e ekosistemit sipërmarrës.

Kjo strategji synon të përshkruajë rrugën e Shqipërisë drejt krijimit të **një ekosistemi sipërmarrës të bazuar në njohuri, i cili do të jetë në gjendje të krijojë mundësi dhe të lejojë kontribimin e qytetarëve të saj në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror përmes inovacionit.**

Qasja e kësaj strategjie ndaj zhvillimit institucional është të parandalojë pengesat e mundshme institucionale të rritjes ekonomike dhe të kthejë mjedisin institucional të Shqipërisë në lehtësues të nismave sipërmarrëse. Për ta arritur këtë, ne do të lehtësojmë dialogun ndërmjet të gjithë aktorëve përkatës në ekosistem duke i bërë pjesë e mekanizmave të qeverisjes për të krijuar dhe zbatuar këtë strategji.

Për më tepër, kjo strategji synon të përdorë mekanizmat kombëtarë të financimit dhe instrumentet e BE-së të disponueshme para anëtarësimit, për të krijuar infrastrukturën që mbështet bizneset e reja dhe sipërmarrësit. Ajo do të eksplorojë mjedisin institucional të BE-së për t'u siguruar sipërmarrësve shqiptarë akses në mundësitë e BE-së për sipërmarrje, inovacion dhe biznese të reja.

Strategjia përshkruan një rrugëtim specifik shqiptar, një moment historik të rëndësishëm të përpjekjes kombëtare për të përqafuar një kulturë sipërmarrëse produktive dhe për t'u bërë një lojtar rajonal në ofrimin e një mjedisi rritjeje dhe terreni pjellor për inovacion.

Delina Ibrahimaj

Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit

DREJT EKOSISTEMIT KOMBËTAR SIPËRMARRËS

Në natyrë, një ekosistem është një grup gjallesash të lidhura që bashkëjetojnë dhe zhvillohen së bashku. Një ekosistem përbëhet nga tre elementë: mjedisi dhe vendndodhja në të cilën ai ekziston; popullsia e ekosistemit, e cila njëkohësisht ndikon dhe ndikohet nga zhvillimi i tij; dhe ndërveprimet, simbioza dhe ndërvarësia ndërmjet anëtarëve të popullsisë së ekosistemit. Në mënyrë të krahasueshme, një ekosistem inovacioni është një rrjet shpikësish, biznesesh të reja, palësh të interesuara, investitorësh dhe sipërmarrësish që bashkëpunojnë për të transformuar idetë në mallra dhe shërbime që ofrojnë vlerë për tregun. Ky bashkëpunim mes aktorëve nënkupton shkëmbimin e njohurive, gjë që e bën atë një ekosistem të hapur inovacioni për nga natyra e tij.

Kjo strategji synon të krijojë një lidhje produktive midis aktorëve të ekosistemit dhe të mundësojë rrjedhën e njohurive përtej kufijve organizativ të aktorëve të ekosistemit për të ofruar një mjedis të përshtatshëm për rritjen dhe zhvillimin e sipërmarrjes. Një ekosistem i tillë i bazuar në njohuri përfshin grupe të shumta aktorësh. Gjithashtu, ai përfshin një grup kompleks kanalesh dhe instrumentash që synojnë të krijojnë lidhje mes tyre. Ky kapitull fillimisht do të përshkruajë natyrën e ekosistemit sipërmarrës nga këndvështrimi i inovacionit, shtresëzimeve të tij dhe nga perspektiva e helikave të shumëfishta. Paragrafi i mëposhtëm do të trajtojë vlerat e përbashkëta të aktorëve të ekosistemit, misionin dhe qëllimin e kësaj strategjie. Së fundmi, ai do të përshkruajë fazat operative të zhvillimit të ekosistemit.

Marrëdhënia me Kornizën Strategjike Kombëtare dhe të BE-së

Kjo strategji lidhet me strategjitë rajonale dhe ndërkombëtare, planet e veprimit dhe kornizat ligjore kombëtare. Ajo përqendrohet në një mjedis ku përfshihen shumë palë dhe ofron një qasje për krijimin e një ekosistemi që mbështetet në njohuri dhe kreativitet.




Figura 2. Ndërlidhja e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative me elementët e kuadrit strategjik dhe ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Vlerat e Përbashkëta të Ekosistemeve Sipërmarrëse

Krijimi i vlerave të përbashkëta paraqet një strategji të rëndësishme diferencimi për ekosistemin sipërmarrës shqiptar. Në kontekstin ku bashkëpunimi midis aktorëve të ekosistemit në nivele mikro, të mesëm dhe makro është kritik për efikasitetin e ekosistemit, krijimi i strategjive të vlerave të përbashkëta të ekosistemit redukton ndikimet negative dhe konfliktet midis aktorëve, ndërkohë që rrit performancën e tyre financiare, sociale dhe mjedisore. Kjo strategji do të zbulojë vlerat e përbashkëta ndërmjet aktorëve përkatës të ekosistemit dhe do t'i paraqesë ato në fazën përfundimtare.

Misioni dhe Vizioni i Ekosistemit Sipërmarrës

Strategjia Shqiptare e Sipërmarrjes synon të caktojë një mision që drejton ekosistemin sipërmarrës dhe inovacionin për të zgjidhur çështjet më urgjente brenda kufijve kombëtar dhe në nivel global. Një mision kombëtar është një mjet i fuqishëm për të lidhur përpjekjet dhe burimet rreth një qëllimi me interes sipëror për popullatën. Kështu, një mision mund të fokusojë kërkimin, inovacionin dhe investimet rreth problemeve kritike shoqërore duke krijuar rritje ekonomike, punësim dhe efekte anësore pozitive në sektorë të ndryshëm të prodhimit.

Qeveria është përgjegjëse për nxitjen e inovacionit, veçanërisht në fushat strategjike në planin afatgjatë. Shteti mund dhe duhet të luajë këtë rol thelbësor pasi nuk orientohet nga kritere investimi afatshkurtra, gjë që e lejon atë të jetë më i guximshëm se sektori privat. Nga këndvështrimi i kësaj strategjie, shteti shqiptar duhet të udhëheqë investimet në infrastrukturën e inovacionit.

Strategjia e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative është një mision kombëtar që synon t'i përgjigjet vizionit të **Shqipërisë si një ekonomi sipërmarrëse, e qëndrueshme dhe krijuese bazuar në inovacion, bashkëpunim proaktiv dhe besim.**

Misioni i ekosistemit sipërmarrës është **rritja e konkurrueshmërisë ekonomike të Shqipërisë nëpërmjet inovacionit duke ofruar masa të synuara për të zhvilluar një ekosistem të begatë sipërmarrës që inkurajon sipërmarrësit dhe investitorët nëpërmjet shërbimeve dhe politikave proaktive.**

Në vitin 2030, Shqipëria do të ketë një ekosistem sipërmarrës të njohur globalisht dhe do të jetë një magnet për investime. Sipërmarrësit shqiptarë do të kenë akses në kapitalin e nevojshëm për të zhvilluar projektet e tyre; ata do të udhëhiqen nga njohuritë e sipërmarrësve të tjerë me biznese të suksesshme dhe do të mbështeten nga një rrjet shërbimesh publike dhe programe asistence që do t'ua lehtësojnë rrugën. Ekosistemi shqiptar shquhet për cilësinë e produkteve dhe shërbimeve që krijon.

Shqipëria 2030 është një vend për talente. Shqiptarët dhe sipërmarrësit nga të gjitha anët e globit kanë zgjedhur Shqipërinë si një vend për të nisur idetë e tyre, për të parë projektet e tyre të rriten dhe për të zgjeruar operacionet e tyre ndërkombëtare. Është një vend ku profesionistët e nivelit të lartë mund të mendojnë në kontekst më të gjerë dhe të ndërtojnë projekte revolucionare duke kaluar përtej kufijve ekzistues në sektorët e tyre.

Shqipëria 2030 është një vend që promovon aftësinë për rritje të kompanive të saj. Çdokush me një ide dhe talent të madh mund ta bëjë këtë, duke patur akses në infrastrukturën e nevojshme për t'u rritur dhe zhvilluar. Kompanitë kanë një udhërrëfyes që u lejon atyre të zgjerohen dhe të ndërkombëtarizohen.

Ekosistemi shqiptar i sipërmarrjes 2030 mbështetet nga institucione të krijuara bazuar në politikat afatgjata që mbështesin grupe të ndryshme sipërmarrësish.

Në vitin 2030, Shqipëria është një nga vendet lider në Europë në inovacion. Kjo arritje është për shkak të mbështetjes së sipërmarrjes novatore, akademisë dhe sektorit të biznesit, nga startup-et tek kompanitë e mëdha të ekonomisë sonë në sektorët kryesorë nxitës: Turizëm, Energji, TIK, Prodhim, Agrobiznes dhe BPO.

Në vitin 2030, zonat rurale shqiptare ofrojnë mundësi ekonomike për të gjithë. Rajonet e Shqipërisë kanë mjetet për të krijuar mundësi ekonomike novatore, që përfitojnë nga burimet e një rajoni, ruajnë talentet lokale dhe tërheqin talente nga komunitete dhe madje vende të tjera.

Ky dokument do të përcaktojë një rrugë të qartë dhe angazhimin e qeverisë së Shqipërisë për ta vendosur vendin tonë në krye të teknologjisë globale dhe të njohurive të reja, përmes vrullit të krijuar nga sipërmarrja inovative.

Të Kuptuarit e Ekosistemit të Sipërmarrjes

Strategjia e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative kërkon mobilizimin e aktorëve të ndryshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, publik dhe privat, si dhe pjesëmarrjen e përkushtuar të të gjitha ndërmarrjeve publike dhe përfshirjen e niveleve të ndryshme administrative në të gjithë territorin.

Perspektiva e Inovacionit të Hapur

Sipërmarrësit, veçanërisht ata në bizneset e vogla dhe ato fillestare, përjetojnë tensionin e natyreshëm që lind nga varësia nga partnerë të jashtëm për të plotësuar përpjekjet e brendshme për inovacion, ndërkohë që kanë burime të pamjaftueshme për të mbikëqyrur procese të tilla të inovacionit. Duke marrë parasysh rëndësinë e përpjekjeve të koordinuara që përfshijnë aktorë të shumtë, kjo strategji trajton sfidat e inovacionit nga këndvështrimi i bizneseve startup dhe NVM-ve inovatore në nivel ekosistemi të biznesit. Kjo strategji parashikon vendosjen e menaxhimit të ekosistemit sipërmarrës që nxit praktikën e inovacionit të hapur. Me fjalë të tjera, do të krijojë proceset e inovacionit të hapur të menaxhuara nga Ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe Agjencia Startup Albania, për të formuar rrjete aktorësh përkatës që njohin praktikën më të mira. Qasja do të hartohet për të ndikuar në mentalitetin dhe kulturën sektoriale³. Një ndikim i tillë social ka nevojë për planifikim të kujdesshëm dhe nënkupton angazhim në të gjitha nivelet e ekosistemit.

Prandaj, prezantimi i praktikave të inovacionit kërkon ndryshimin dhe menaxhimin e mendësisë dhe kulturës sektoriale, si dhe ndërhyrjen në krijimin e infrastrukturës që mbështet këto praktika, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe njohurive ndërmjet aktorëve. Infrastruktura e inovacionit siguron kanalet e nevojshme për të mundësuar një ndërveprim të tillë. Të aplikuara së bashku, ato synojnë të ndryshojnë kulturën dhe mentalitetin sektorial⁴. Më pas, një përshkrim i qasjes së palëve të interesuara në shumë nivele do të ndihmojë në kuptimin e marrëdhënies së aktorëve të ekosistemit në kontekstin e inovacionit të hapur.

Perspektiva e Aktorëve

Kjo strategji mbështetet në një qasje me shumë nivele ndaj inovacionit, e cila përfshin perspektiva të nivelit mikro, të mesëm dhe makro.⁵ Niveli mikro përfshin firma dhe organizata individuale. Rrjetet dhe bashkëpunimet e kompanive, duke përfshirë partneritetet dhe bashkëpunimin ndër-organizativ, përfshihen në nivelin e mesëm.⁶ Së fundmi, niveli makro përfshin faktorë socialë dhe mjedisorë si qeveria dhe politikat (Figura 2). Garcia et al. (2019) argumentojnë se të tre nivelet duhet të merren parasysh për risitë që përfshihen në kategorinë eko.

Grupet e interesit të nivelit makro janë shumë të rëndësishëm dhe ndikojnë në kompanitë startup dhe ekosistemin sipërmarrës. Sektori publik është një nga aktorët kryesorë në shoqëri kur bëhet fjalë për çështjet socio-ekonomike. Në nivelin makro, politikat publike dhe mbështetja politike janë faktorë të rëndësishëm mundësues për industrinë e përgjithshme dhe ekosistemin sipërmarrës. Sa i përket mbështetjes kombëtare, niveli makro është vendi ku aktorët qeveritarë mund të kontribuojnë më shumë. Politika publike luan një rol vendimtar në vendosjen e shinave për të gjitha zhvillimet. Mjedisi socio-ekonomik që qeveria mund të sigurojë, ndikon në potencialin e çdo

ndërmarrje. Infrastruktura e duhur, një mjedis i përshtatshëm ligjor dhe mbështetja financiare janë vetëm disa elementë që qeveria mund të realizojë.

Për vazhdimin e qëndrueshëm të këtij projekti, është thelbësore të promovohet një qasje efikase dhe efektive për startup-et me aktorë të ndryshëm që mund të ndikojnë në politikat publike. Prerogativat e politikave publike mund të ndryshohen lehtësisht me vullnetin publik dhe politik. Dy nëngrupe që i përkasin këtij niveli janë organet e qeverisjes qendrore dhe vendore. Organet e qeverisë qendrore janë të rëndësishme për formimin e mbështetjes operacionale dhe strategjive qeveritare për startup-et shqiptare. Kjo vlen për nivelet kombëtare, rajonale dhe lokale. Agjencitë qeveritare dhe misionet diplomatike luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin, financimin, zbulimin e tregut dhe informacionin mbi mundësitë e eksportit.

Niveli i mesëm përbëhet nga universitetet, institutet, rrjetet financiare dhe shoqatat profesionale. Kompleksiteti dhe konkurrenca e bizneseve startup kërkojnë aftësi të avancuara dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional për individët e angazhuar. Kjo është për shkak se industria kërkon rritje të vazhdueshme dhe përvetësim njohurish për t'u përshtatur me dinamikën gjithnjë në ndryshim të tregut. Nevoja për të zhvilluar kapacitetet e bizneseve startup kërkon një gamë të gjerë aftësish, duke filluar nga njohuritë për zhvillimin e produkteve të reja dhe aftësitë kompjuterike e dixhitale, deri tek ato që lidhen me industrinë dhe teknologjinë, si p.sh. përdorimi i teknologjive të reja. Ndërmarrjet startup duhet të jenë në krye të zhvillimeve të reja për të siguruar pozicionin e tyre. Kombinimi i kreativitetit dhe inovacionit për të mbështetur mendimin sipërmarrës do të sigurojë qëndrueshmërinë e tyre. Për më tepër, zhvillimi i aftësive sipërmarrëse dhe përdorimi i njohurive dhe kulturës së krijuar si bazë për inovacion do të mundësojë lulëzimin e bizneseve fillestare.



Figura 3. Ekosistemi i startup-eve në Shqipëri dhe aktorët e tij.

Palët e interesuara nga niveli mikro janë bizneset startup, NVM-të dhe ndërmarrjet që po zhvillojnë produkte/shërbime/eksperienca të reja dhe inovative. Roli i agjentëve në ekosistemin e sipërmarrjes është thelbësor për shkak të nevojës për të lidhur ekonominë me tregun dhe sepse ata mund të lehtësojnë pikat hyrëse dhe marketingun për prodhimet standarde dhe inovative të bizneseve startup. Për këtë arsye, është thelbësore të përfshihen të gjithë aktorët e mikroekosistemit në aktivitetet e ardhshme të zhvillimit. Meqenëse niveli mikro përfshin një gamë të gjerë aktorësh të madhësive dhe moshave të ndryshme, në këtë strategji, do të fokusohemi veçanërisht në tre lloje organizatash: startup-et, scale-up-et dhe sipërmarrjet me rritje të lartë:

- » **Një startup** kuptohet si një kompani në një fazë të hershme zhvillimi që e bazon biznesin dhe aktivitetin e saj në teknologji për t'u rritur shpejt. Në fazat e tyre të hershme, startup-et janë me risk për shkak të nivelit të lartë të kërkimit në lidhje me produktet, shërbimet dhe proceset e tyre dhe për shkak se ato sjellin një devijim nga modelet tradicionale të biznesit. Megjithatë, kjo do të thotë gjithashtu se nëse janë të suksesshme, startup-et janë kompanitë që gjenerojnë produktivitet më të lartë në një kohë më të shkurtër. Për më tepër, sipërmarrja inovative ka gjithashtu efekte të jashtme pozitive në kompanitë e tjera dhe shoqërinë në tërësi, duke promovuar inovacionin, transformimin e industrive tradicionale dhe reduktimin e papunësisë.
- » **Scaleup-et**, sipas Start-up Europe Partnership, janë biznese fillestare që kanë kaluar fazën e mbijetesës dhe kanë arritur një fazë zhvillimi dhe rritjeje⁷ në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve”⁸. Kjo fazë karakterizohet nga zbatimi i modelit të tyre të biznesit dhe vijimi i rritjes së qëndrueshme përsa i përket aksesit në treg, të ardhurave, numrit të punonjësve, krijimit të vlerës për klientët dhe kërkimit të mundësive për partneritete me kompani të tjera të themeluara. Ata shtojnë se, si çdo kompani me kapital të konsiderueshëm, qëllimi i rritjes do të jetë gjithashtu gjenerimi i të ardhurave për investitorët e saj, qoftë përmes blerjes (daljes) ose nxjerrjes në treg të aksioneve (oferta publike fillestare ose IPO).
- » **Ndërmarrjet me rritje të lartë**, janë të gjitha kompanitë që kanë një normë rritjeje vjetore më të madhe se 20%, të qëndrueshme për tre vjet, dhe 10 ose më shumë punonjës⁹. Ato janë kompani të reja, të vogla dhe të mesme, që arrijnë normë të lartë rritjeje, ndonjëherë duke dyfishuar ose trefishuar madhësinë e tyre në një ose dy vjet. Për këto kompani, analiza e performancës fillon me matjen e rritjes, e cila vlerësohet përmes indikatorëve të numrit të punonjësve dhe qarkullimit.

Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit dhe Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startupe-ve dhe Lehtësuesve, Startup Albania, do të jenë aktorët kryesorë në qeverisjen e ekosistemit. Megjithatë, objekti i kësaj strategjie është zgjeruar për të përfshirë sa më shumë aktorë të jetë e mundur. Prandaj, ajo është e hapur për komunitetet autonome, qeveritë lokale, akademinë, sipërmarrësit, komunitetin e biznesit, themeluesit dhe investitorët, përsheptuesit, inkubatorët dhe ndërtuesit e sipërmarrjeve, lehtësuesit, fondacionet, shoqatat, qytetarët dhe shoqërinë civile.

Krahas pamjes shumështrësore të palëve të interesuara dhe ndërveprimit të tyre, kjo strategji kalon përtej Heliksit të Trefishtë¹⁰ dhe e paraqet atë si Pentagramin e Bashkëpunëtorëve (Figura 4), me aktorët e nivelit të mesëm që veprojnë si element «ngjitës» dhe lidhës për të gjithë aktorët e tjerë përkatës. Siç përshkruhet në paragrafin e mësipërm, niveli i mesëm është thelbësor për ruajtjen e lidhjeve në rrjetin e aktorëve dhe zbatimin e politikave. Niveli i mesëm i ekosistemit të startup-eve shqiptar është i pazhvilluar dhe kërkon përpjekje të konsiderueshme nga aktorët e nivelit makro.

Kjo përpjekje nis nga qeveria qendrore. Në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, ajo përfshin qeveritë vendore, si qytetet dhe bashkitë, për të zhvilluar infrastrukturën institucionale duke nxitur inovacionin dhe lidhjet ndërmjet aktorëve. Këto lidhje mbahen përmes infrastrukturës së inovacionit, për të ekzekutuar dhe praktikuar politika që përfshijnë qendrat kërkimore, parqet e teknologjisë, qendrat e transformimit, ofruesit e mjediseve dhe laboratorët e testimeve.




Figura 4. Struktura e pentagramit të ekosistemit të sipërmarrjes shqiptare.

Burime të rëndësishme të njohurive dhe burime të rëndësishme të investitorëve individualë janë akademikët individualë dhe investitorët individualë nga diaspora. Prandaj, kjo strategji do të fokusohet në potencialin e diasporës për forcimin e ekosistemit sipërmarrës shqiptar.

Pas përshkrimit të natyrës së ekosistemit sipërmarrës dhe aktorëve të tij, paragrafi në vijim do të shpjegojë qëllimin e strategjisë dhe do të prezantojë tre shtyllat përkatëse për zhvillimin e ekosistemit.

Elementet e Ekosistemit Sipërmarrës

Pas përshkrimit të aktorëve, kjo strategji identifikon elementet përkatëse për zhvillimin e Ekosistemit Sipërmarrës (Figura 5).

Kultura e një ekosistemi është thelbësore pasi shërben si agjent lidhës. Është e rëndësishme të kemi një kulturë që pranon risqet e kalkuluara në mënyrë të arsyeshme dhe i sheh gabimet si mundësi nxënieje. Një kulturë inovative stimulon kreativitetin dhe eksperimentimin dhe sfidon mendësinë tradicionale. Ndhmon gjithashtu në kultivimin e një mentaliteti inovativ. Ambicia, vendosmëria dhe vullneti për të pasur sukses promovohen dhe ilustrohen gjithashtu në një kulturë inovative. Kapaciteti për të komunikuar histori suksesi nga palët e interesuara të ekosistemit të inovacionit paraqet një aspekt themelor të kulturës. Vënia në dukje e arritjeve në të gjithë ekosistemin dhe diskutimi i gabimeve dhe mësimave të nxjerra prej tyre janë thelbësore sepse suksesi ushqen suksesin.

Përfaqësimi i ekosistemit kontribuon në krijimin e mbështetjes për aktivitetet inovative të ekosistemit dhe transformimin dixhital. Kjo nxit një rritje të fuqisë negociuese të aktorëve të ekosistemit me sektorin dhe qeveritë lokale, rajonale dhe kombëtare, dhe forcon ndikimin në nivelin e legjislacionit, diplomacisë ekonomike dhe strategjive industriale/sipërmarrëse.

Rrjedhimisht, nëse mbështetja për ekosistemin nga nivelet lokale dhe kombëtare është e fortë, kjo kontribuon në rritjen e prodhimit të produkteve të reja dhe inovacionit, duke stimuluar më tej bizneset fillestare dhe aksesin e NVM-ve në tregjet e zhvilluara.



Figura 5. Elementë të rëndësishëm për zhvillimin e Ekosistemit Sipërmarrës.

Krahas mbështetjes për zhvillim, aksesimi në teknologjitë dixhitale përkatëse mundëson zhvillimin e produkteve/ shërbimeve konkurruese. Produkte ose shërbime të tilla përmbajnë një vlerë të shtuar më të lartë dhe hyjnë më lehtë në tregjet e zhvilluara. Gjithashtu, teknologjitë paraqesin një shtytës të rëndësishëm për aftësinë rritëse të NVM-ve. Me fjalë të tjera, aplikimi i teknologjive të reja mund të ndihmojë NVM-të të rriten shpejt.

Infrastruktura e zhvilluar mirë e inovacionit të hapur dhe K&Zh-së (R&D) mundëson teknologji dixhitale dhe të tjera, të cilat janë të dobishme për zhvillimin e sipërmarrjes dhe ofrojnë njohuri për sistemin arsimor. Sistemi arsimor transferon njohuritë e reja tek sipërmarrësit, duke u mundësuar atyre t'i shndërrojnë ato në njohuri dhe aplikime ekonomike.

Ekosistemi i sipërmarrjes integron këto elementë për t'i shërbyer zhvillimit të sipërmarrjes, e cila është veçanërisht e përqendruar në bizneset fillestare dhe NVM-të. Ekosistemi i sipërmarrjes mundëson inovacion dhe komunikim të hapur midis aktorëve të ndërruar, duke mbështetur drejtpërdrejt ose tërthorazi rritjen e tyre.

Shtyllat e Strategjisë së Sipërmarrjes

Strategjia e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative e mbështet ekosistemin e sipërmarrjes deri në vitin 2030, duke krijuar dhe udhëhequr një model të ri ekonomik të sipërmarrjes novatore që do të ketë efekte të qëndrueshme në objektivat tona të përbashkëta. Strategjia do të stimulojë rritjen e ekosistemit të startup-eve dhe gjenerimin e qarqeve të virtytshme brenda tij dhe sektorëve ekonomikë nxitës të vendit. Si rezultat i stimulimit të rritjes së bazuar në krijimtari, do të rritet produktiviteti ekonomik dhe do të mundësohet sigurimi i vendeve cilësore të punës për sa më shumë njerëz. Me pak fjalë, kjo strategji hedh themelet për ndryshimin e krijimit të vlerave kombëtare të Shqipërisë siç e njohim sot.

Strategjia mbështetet në tre shtylla, të cilat janë ilustruar në Figurën 1 më sipër:

1. Ekosistemi Inovativ Sipërmarrës
2. Sektorët Strategjik (S3)
3. Zhvillimi Gjithëpërfshirës

Ekosistem Sipërmarrës Inovativ

Aktualisht, sipërmarrja inovative përfaqëson një sektor të vogël të ekonomisë, por ka potencial për të gjeneruar fitime të mëdha dhe punësim cilësor. Sipas OECD-së, 4-6% e kompanive me rritje të lartë kontribuojnë në krijimin e 50-75% të vendeve neto të punës në vendet e zhvilluara.¹¹

Për sa i përket sipërmarrjes inovative, synimi ynë është të ofrojmë kuadrin më të mirë të mundshëm për këtë sektor, duke ndërtuar një ekosistem të fortë, të hapur dhe inovativ për sipërmarrjen. Kështu, ajo zë një vend qendror në një plan model që synon të gjenerojë vlerë brenda sektorëve kryesorë ekonomikë. Këta sektorë përfaqësojnë pikat kyçe të forta të ekonomisë së vendit, por gjithashtu mund të nxisin zhvillimin e nënsektorëve të rinj.

Infrastruktura e Inovacionit: Një kuadër organizativ për të mundësuar shkëmbimin e njohurive midis aktorëve të ekosistemit. Ai përfshin kapacitetet e K&Zh&I dhe zgjeron rrjetin e aktorëve kombëtarë në nivel rajonal dhe global. Kjo u mundëson aktorëve kombëtarë të ekosistemit të përthithin njohuri të reja, t'i transformojnë ato në njohuri ekonomike dhe të zhvillojnë dhe prezantojnë produktet/ shërbimet e tyre në nivel rajonal dhe global, duke e kthyer Shqipërinë në një ekonomi të dijes.

Dimensioni i Talentit: Kompeticioni ndërkombëtar i talenteve fokusohet në zhvillimin, tërheqjen dhe ruajtjen e sipërmarrësve më të mirë. Për ta bërë Shqipërinë një komb sipërmarrës, ne duhet ta kthejmë vendin tonë në një magnet talentesh, të aktivizojmë talentin akademik, të forcojmë profesionistët ekzistues dhe të tërheqim në Shqipëri sipërmarrës nga diaspora dhe të huaj.

Dimensioni i Investimit: Kjo Strategji synon të përshpejtojë ciklin e investimeve në Shqipëri. Qëllimi i saj është të rrisë kapacitetet investuese paralelisht me rritjen e kompanive shqiptare, në mënyrë që ato të krijojnë dhe ruajnë bazën e tyre operative në Shqipëri gjatë gjithë ciklit të tyre të rritjes.

Dimensioni i Zgjerimit dhe Ndërkombëtarizimit: Rritja e vogël e kompanive shqiptare ndikon në potencialin e mbijetesës së këtyre kompanive dhe fuqinë e ekonomisë së vendit. Në sektorin e sipërmarrjes inovative, kompanitë zhvillohen përmes fazave të ideimit, vlefshmërisë dhe zgjerimit.

Nëse Shqipëria siguron mbështetje të vazhdueshme për bizneset fillestare gjatë gjithë ciklit të tyre, do të mundësojë ruajtjen dhe rritjen e numrit të sipërmarrjeve në zhvillim. Në vend që të zhduken apo të mbeten në përmasa të vogla, këto kompani do të kenë mundësinë të zgjerohen në një mjedis që nxit rritjen. Duke i mbështetur nga fazat fillestare deri te zgjerimi, ato mund të shndërrohen në motorë kryesorë të krijimit të vendeve të reja të punës për të ardhmen e vendit.

Sektorët Strategjikë (S3)

Një ekosistem inovativ i sipërmarrjes do të influencojë pozitivisht aktorët e tij së bashku me sektorët nxitës në vend. Strategjia mbështetet në sektorët prioritarë të ekonomisë shqiptare, të përcaktuar në Strategjinë e Specializimit Inteligent (S3). Fokusi është në sektorët në të cilët Shqipëria është më e pozicionuar për të konkurruar në nivel global dhe aty ku ndikimi i inovacionit mund të sjellë përfitime më të mëdha për ekonominë dhe shoqërinë.

Këta sektorë kombinojnë kompetencat e nevojshme, duke u mundësuar aktorëve të ekosistemeve që t'u përgjigjen sfidave globale, të testojnë produkte të reja dhe të krijojnë mundësi për zhvillimin e tregjeve të reja, kompanive dhe burimeve njerëzore. Më e rëndësishmja, sektorët nxitës përfaqësojnë gjithashtu një mundësi për bizneset shqiptare për të zhvilluar nën-sektorë të rinj të industrisë, duke optimizuar shpërndarjen e burimeve dhe duke investuar në potencialin e rritjes përmes shpikjeve dhe teknologjive të avancuara të së ardhmes.

Gjashtë sektorët strategjik prioritarë janë:

- **Agrobiznesi**
- **Energjia**
- **Turizmi**
- **TIK-u**
- **Prodhimi**
- **Business Process Outsourcing (BPO)**

Përveç gjashtë sektorëve strategjikë prioritarë, në Figurën 6 më poshtë paraqiten edhe sektorë dhe sisteme ekonomike shtesë me potencial për zhvillim.



Figura 6. Sektorë, nën-sektore dhe sisteme ekonomike shtesë me potencial për zhvillim.

Zhvillimi Gjithëpërfshirës

Shtylla horizontale synon vendosjen e barazisë sociale në ekosistemin e sipërmarrjes. Në këtë kuadër, ajo do të krijojë mundësi për shtresa të ndryshme të shoqërisë që të marrin pjesë në zhvillimin ekonomik të vendit, të përfitojnë nga mbështetja qeveritare dhe të nxisin transformimin në komunitete dhe rajone të ndryshme.

SIPËRMARRJA E GRAVE:

Një hendek i krijuar nga pabarazia midis burrave dhe grave në çdo kategori të caktuar.

ZHVILLIMI RAJONAL:

Përqendrohet në pabarazinë që lind nga vendi i origjinës ose vendbanimi i individëve.

PËRFSHIRJA E BREZAVE:

I referohet pabarazisë së lidhur me moshën, e cila zakonisht është më e theksuar te të moshuarit, por ndikon gjithashtu edhe te të rinjtë.

Ky model, sipas shtyllave me tre nivele të ndërlidhura, do të ndihmojë në krijimin e më shumë bizneseve, rritjen e produktivitetit, hapjen e më shumë vendeve cilesore pune dhe një rritje ekonomike më të barabartë dhe të qëndrueshme. Prandaj, **kjo strategji shkon përtej çdo sektori dhe përfshin një mision të vërtetë kombëtar që promovon ide të reja të rëndësishme për kulturën inovative dhe krijon mjedisin për zhvillimin e startup-eve dhe ndërkombëtarizimin e tyre.**

SITUATA DHE DIAGNOZA

Objektivat Strategjike

Strategjia Shqiptare e Sipërmarrjes është hartuar si një përpjekje kombëtare për të krijuar një kuadër të ri ekonomik, të bazuar në sipërmarrjen inovative brenda industrive kryesore. Ne synojmë të përdorim inovacionin si një katalizator për ndryshimet sociale dhe ekonomike. Ky plan është hartuar për katër qëllime, siç u përmend në hyrje: Infrastruktura e Inovacionit të Hapur, Talenti, Investimi dhe Aftësia për Rritje. Do të krijohen tregues për të matur progresin drejt këtyre katër objektivave përmes modelit të qeverisjes së Strategjisë së Sipërmarrjes në Shqipëri. Po ashtu, strategjia do të hapë rrugën për vendosjen e menaxhimit efektiv dhe efikas të qeverisjes përmes infrastrukturës së inovacionit të hapur.

Infrastruktura e Inovacionit | fizike dhe virtuale

Infrastruktura e inovacionit të hapur përfshin qasje institucionale dhe joinstitucionale për të nxitur rrjedhën e njohurive në të gjithë ekosistemin. Kjo do të ndihmojë në transformimin e Shqipërisë në një shoqëri të bazuar në dije, ku ekosistemi i sipërmarrjes do të forcohet duke krijuar vlerë shtesë përmes bashkëpunimit me aktorë nga të gjitha shtresat.

Sektori publik është përgjegjës për formulimin e politikave të përshtatura për veçoritë dhe funksionet unike të inovacionit dhe sipërmarrjes. Ai duhet të sigurojë që rregulloret të përshtaten me mjedisin në të cilin zhvillohen iniciativa të tilla, duke eliminuar pengesat që mund të kufizojnë rritjen e tyre. Po ashtu, duhet të jetë proaktiv në promovimin e këtyre iniciativave. Nga analiza e kuadrit rregullator, evidentohet se zhvillimi i politikave në mbështetje të sipërmarrjes ka qenë shumë aktiv vitet e fundit – në nivel lokal, rajonal, shtetëror dhe europian – dhe ka qenë një prioritet për të gjitha qeveritë.



Krijimi i agjencisë Startup Albania do të ndihmojë në zbatimin e masave, koordinimin e aktorëve, promovimin e ekosistemit tek aktorët e jashtëm, mbështetjen e startup-eve dhe krijimin e mjedisit të nevojshëm për zhvillimin e nxitësve për rritjen e investimeve.

Gjatë vitit 2022, qeveria miratoi Ligjin për Startup-et dhe Lehtësuesit, duke ofruar një kuadër ligjor për sipërmarrësit, bizneset startup, nomadët dixhital dhe organizatat mbështetëse të ekosistemit. Ligji parashikon disa masa që mbështesin zhvillimin dhe rritjen e startup-eve në Shqipëri dhe heq barrierat për nomadët dixhital për t'u vendosur dhe punuar në qytetet tona. Ndërkohë që ekziston konteksti ligjor, Strategjia e Zhvillimit të Sipermarrjes Inovative do të sigurojë kuadrin e punës për aktorët e ekosistemit, duke përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm, për të arritur objektivat tona të përgjithshme. Përmirësimi, konsolidimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i Agjencisë Startup Albania do të ndihmojë në zbatimin e masave, koordinimin e aktorëve, promovimin e ekosistemit tek aktorët e jashtëm, mbështetjen e bizneseve startup dhe krijimin e mjedisit të nevojshëm për zhvillimin e nxitësve për rritjen e investimeve në sipërmarrjen inovative.

Agjencia synon të zhvillojë masa të standardizuara për

programet e asistencës teknike, të krijojë mundësi për aktorët e ekosistemeve që të përfshihen dhe të koordinojë ndihmën ndërkombëtare që është e orientuar ndaj startup-eve dhe aktorëve të ekosistemit, si parqet teknologjike, inkubatorët, përshpejtuesit dhe ndërtuesit e sipërmarrjeve.

Institucionet do të krijojnë infrastrukturë fizike dhe virtuale për avancimin e aftësive dhe zhvillimin e komunitetit. Strategjia jonë parashikon zhvillimin e Qendrave Rajonale të Transformimit ku sipërmarrësit lokalë mund të kenë akses në rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare të njohurive, shërbimet e specializuara, instrumentet dhe financimet përmes masave të vazhdueshme dhe të kualifikuara. Qendrat Rajonale të Transformimit do të pajisen me resurse për të ofruar shërbime profesionale për sipërmarrësit dhe bizneset fillestare, si dhe ambiente bashkëpunimi dhe hapësira komunitare ku mund të realizohen aktivitete, seminare dhe programe për përmirësimin e aftësive. Objektet synojnë të ofrojnë asistencë këshillimore publike, private dhe ndërkombëtare, mundësi financimi dhe shërbime mentorimi gjatë gjithë vitit, brenda një kuadri të përcaktuar.

Në nivel kombëtar, synojmë zhvillimin e parqeve teknologjike që ofrojnë inovacion dhe K&Zh, përthithjen e më shumë fondeve nga organizatat ndërkombëtare dhe lehtësime fiskale për kompanitë që prodhojnë produkte dhe shërbime, krijojnë patenta dhe implementojnë teknologji inovative brenda kësaj infrastrukture. Parqet do të funksionojnë si objekte multifunksionale, të pajisura me hapësira dhe infrastrukturë moderne për mbështetje të komuniteteve të ndryshme.



Qendrat Rajonale të Transformimit do t'u mundësojnë sipërmarrësve lokalë të aksesojnë rrjetet kombëtare dhe ndërkombëtare të njohurive, shërbimet e specializuara, mjetet dhe financimet përmes instrumenteve të vazhdueshme dhe të kualifikuara.

Brenda këtyre parqeve, do të angazhohen aktorë të rëndësishëm të K&Zh&I, korporata, aktorë të biznesit ndërkombëtar dhe kompani të mëdha të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Parqet do të mbështesin bizneset fillestare dhe do të ofrojnë lehtësime për zhvillimin e teknologjive të avancuara, duke përfshirë shërbime të specializuara si mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe mundësi për tregti pa taksa. Ne synojmë të krijojmë platforma virtuale me kurrikulat dhe programet e nevojshme, në mënyrë që çdo qytetar, kudo që ndodhet në vend, të ketë akses në të njëjtat shërbime si ato në mjedisin fizik. Platformat do të mbulojnë faza të ndryshme të rritjes, do të kontribuojnë në përmirësimin e aftësive dhe rikualifikimin, dhe do të ofrojnë mjetet e nevojshme për lidhjen me themelues, mentorë dhe investitorë të tjerë. Avancimi dhe zgjerimi i shërbimeve publike dixhitale e vendos Shqipërinë në një pozicion unik, madje edhe në krahasim me vendet e BE-së, duke mundësuar një infrastrukturë operacionale të qëndrueshme që mbështet bizneset fillestare dhe sipërmarrësit në realizimin e objektivave të tyre të biznesit.

Në kuadër të përpjekjeve globale për kalimin në një ekonomi të qëndrueshme dhe të dixhitalizuar, Shqipëria ka si qëllim mbështetjen e zhvillimit të sipërmarrjeve që fokusohen në zgjidhje të gjelbra dhe dixhitale. Ky proces përfshin nxitjen e startup-eve dhe inkubatorëve që operojnë në fushat e energjisë së rinovueshme, efikasitetit të energjisë, teknologjive dixhitale dhe inteligjencës artificiale. Zhvillimi i ekonomisë së gjelbër dhe dixhitale paraqet një mundësi kyçe për Shqipërinë për të përshpejtuar rritjen ekonomike dhe modernizimin e saj, duke ndjekur shembujt e vendeve të tjera të suksesshme si Baltiku, Sllovenia dhe Kroacia. Në këto shtete, teknologjitë dixhitale dhe zgjidhjet mjedisore të qëndrueshme kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e produktivitetit dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Për shembull, në Estoni, ekonomia dixhitale përbën rreth 13% të PBB-së¹², ndërsa Sllovenia ka investuar 3% të PBB-së në hulumtime dhe zhvillim të teknologjive të gjelbra¹³, duke u pozicionuar si një lider në rajonin e Ballkanit në fushën e inovacionit dhe qëndrueshmërisë.

Krahasuar me vendet më të zhvilluara të Evropës Juglindore, si Kroacia, ku turizmi i qëndrueshëm dhe ekonomia e gjelbër kanë pasur një ndikim të madh në diversifikimin e burimeve ekonomike, Shqipëria ka një potencial të madh për të shfrytëzuar inovacionet dixhitale dhe të gjelbra për rritje afatgjatë. Përdorimi i teknologjive të pastra dhe dixhitale mund të ndihmojë në

përmirësimin e infrastrukturës energjetike, të rrisë efikasitetin në sektorët strategjikë si bujqësia dhe turizmi, dhe të tërheqë më shumë investime nga donatorë ndërkombëtarë dhe Bashkimi Evropian. Përvoja e vendeve si Sllovenia dhe Kroacia tregon se përqafimi i agjendave të gjelbra dhe dixhitale jo vetëm që përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve, por gjithashtu rrit aftësinë konkurruese të vendit në tregjet globale.

Iniciativat për financimin dhe investimet, synojnë krijimin e një fondi të posaçëm për mbështetje financiare të startup-eve që fokusohen në teknologjitë e gjelbra dhe dixhitale. Ky fond do të financohet nga buxheti i shtetit dhe Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor. Po ashtu, strategjia nxit investimet private në sektorët e gjelbër dhe dixhital përmes ndërtimit të incentivave për investitorët dhe korporatat.

Në kuadër të asistencës teknike, do të zhvillohen programe që ofrojnë mbështetje të specializuar për startup-et dhe inkubatorët e angazhuar në projekte që synojnë reduktimin e ndotjes dhe përparimin teknologjik. Gjithashtu, do të krijohen platforma dixhitale për trajnimin e sipërmarrësve



Do të zhvillohet një program vjetor që do të ofrojë stimuj për të rritur pjesëmarrjen dhe do të lidhë komunitetin me iniciativa ndërkombëtare që mbështesin aktivizimin e themeluesve të rinj.

dhe për shpërndarjen e njohurive në fushat e teknologjive të reja dhe praktikave të qëndrueshme. Plani përfshin mbështetje për krijimin e inkubatorëve të teknologjisë së gjelbër dhe dixhitale në disa rajone të Shqipërisë, si dhe ngritjen e qendrave të inovacionit në bashkëpunim me agjenci të tjera shtetërore dhe institucione akademike. Këto qendra do të fokusohen në zhvillimin e teknologjive të pastra dhe dixhitale, duke ofruar hapësira bashkëpunimi, mentorim dhe qasje në fonde për startup-et.

Talenti | zhvillimi, ruajtja dhe tërheqja

Talenti është çelësi i suksesit të ekosistemit kombëtar të sipërmarrjes. Sistemet ekonomike më dinamike të botës përbalen me vështirësi në trajnimin, rekrutimin dhe ruajtjen e fuqisë punëtore të kualifikuar, si dhe në ruajtjen e motivimit të këtij kapitali njerëzor. Kompanitë, kombet dhe komunitetet shqetësohen për trajtimin e këtyre sfidave, sepse lufta për të tërhequr talentin më të madh është bërë globale. Zhvillimi, ruajtja dhe tërheqja e talentit janë tre komponentë thelbësorë përmes të cilëve kjo Strategji do të realizojë qëllimin e saj të lidhur me talentin.

ajta dhe tërheqja e talentit janë tre komponentë thelbësorë përmes të cilëve kjo Strategji do të realizojë qëllimin e saj të lidhur me talentin.

Sistemi ynë arsimor po përballlet me sfida të rëndësishme në disa fusha kyçe, përfshirë konsolidimin e udhëzimeve akademike dhe profesionale për të reduktuar hendekun dhe përmirësuar aksesin e studentëve në lëndët STEM. Njëkohësisht, po kërkohet rritja e ndërgjegjësimit të studentëve për mundësitë e punësimit, ofrimi i alternativave arsimore që mundësojnë përvojë prak-



Përmes një identifikimi të kujdesshëm, aktiviteteve promovuese të orientuara dhe angazhimit të diasporës, do të theksojmë përfitimet e ngritjes së operacioneve të kompanive në Shqipëri.

tike dhe bashkëpunimi i ngushtë me kompanitë për të trajnuar profesionistët, duke i përgatitur ata për tregun e punës.

Kjo strategji synon të nxisë një pjesëmarrje më të madhe në trajnime praktike të biznesit, si në nivelin e shkollës së mesme, ashtu edhe në atë universitar. Ajo parashikon krijimin e programeve të fokusuara në trajnimin e hershëm për sipërmarrjen dhe adresimin e kulturës, me synimin që studentët ta perceptojnë sipërmarrjen si një mundësi të vlefshme për karrierë. Gjithashtu, do të zhvillohet një program vjetor që do të ofrojë stimuj për të rritur pjesëmarrjen dhe do të lidhë komunitetin me iniciativa ndërkombëtare që mbështesin aktivizimin e themeluesve të rinj.

Një objektivi tjetër për talentet është studimi i doktoraturës. Pavarësisht se përfaqësojnë një pjesë të vogël të popullsisë, rritja e investimeve do të krijojë mundësi për formimin e një grupi më të gjerë inovatorësh të mundshëm. Ne do të nxisim

investimet në talentet e K&Zh&I-së për të lehtësuar krijimin e startup-eve të shëndetshme të bazuara në njohuri dhe për të krijuar efekte pozitive dhe të përhapura në sektorët ekonomik, me rezultate të favorshme për ekonominë e përgjithshme. Për më tepër, studime të shumta kanë dëshmuar se bizneset fillestare të lindura nga një bazë akademike janë më të qëndrueshme dhe kanë kapacitet të gjenerojnë më shumë fonde gjatë rrugëtimit të tyre të rritjes.

Një numër i konsiderueshëm studimesh vërtetojnë se talentet dixhitale janë më të prirur të largohen nga vendi për të avancuar karrierën e tyre.¹⁴ Ata kanë arsim të lartë, të ardhura më të larta se mesatarja kombëtare dhe vlerësojnë balancin e shëndetshëm midis jetës profesionale dhe asaj personale. Shqipëria ka nevojë ta ruaj talentin dixhital, me qëllim që individët të kontribuojnë në zhvillimin e kompanive të sektorit të TIK me praninë e tyre operative në vend. Gjatë viteve të fundit, ka pasur një rritje të kompanive ndërkombëtare që kanë zgjeruar aktivitetet e tyre në Shqipëri; megjithatë, gjithashtu ka një tendencë në rritje të profesionistëve të kualifikuar që largohen për mundësi pune jashtë. Ky është një fenomen global, por për shkak të madhësisë së vogël të vendit dhe numrit të kufizuar të profesionistëve të IT-së, situata është sfiduese për shumë industri. Synimi ynë është të ruajmë talentet dixhitale dhe njëkohësisht të tërheqim komunitetet ndërkombëtare për të mbështetur zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.

Duke shfrytëzuar suksesin e industrisë së turizmit në vitet e fundit, do të fokusohemi në tërheqjen e talenteve të huaja përmes mesazheve të targetuara, do të prezantojmë mundësi dhe do të ofrojmë një pikënisje për zhvillimin e ekosistemit të inovacionit në Shqipëri. Përmes një identifikimi të kujdesshëm, aktiviteteve promovuese të orientuara dhe angazhimit të diasporës, do të

theksojmë përfitimet e ngritjes së operacioneve të kompanive në Shqipëri. Gjithashtu, do të evidentojmë mundësitë që mund të shfrytëzohen në sektorë të ndryshëm të industrisë shqiptare, si Energjia, Turizmi, Inovacioni etj.

Vetëm duke përforcuar tre dimensionet e këtij objekti – zhvillimin, ruajtjen dhe tërheqjen e talentëve – Shqipëria do të arrijë të pozicionohet në nivelet më të larta të konkurrencës globale për talentin më të mirë.



Krijimi i fondeve të investimeve, aktivizimi i rrjeteve të investitorëve të biznesit dhe ngritja e instrumenteve të Kapitalit të Korporatave për Sipermarrjen (CVC) janë mënyra për të forcuar bashkëpunimin me ekosistemin e startup-eve.

Investime | përshpejtimi i ciklit të investimeve në Shqipëri

Një ekonomi në rritje ka nevojë për biznese me kapacitete të zhvilluara, kërkon investime dhe përdor inovacionin për të qenë efektive dhe për të përshtatur nevojat e veta ose të tregut.

Shqipëria ka ende nevojë të ndërtojë bazat e nevojshme për të krijuar një klimë të larmishme biznesi. Krahasuar me shtetet fqinje si Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, ajo ka mbetur prapa në instrumentet e disponueshme për financimin e bizneseve startup dhe në vëllimin e përgjithshëm të investimeve nga burime private. Sipas të dhënave të Start-up Genome World Ecosystem Report 2022¹⁵, ekosistemi i Beogradit dhe Novi Sadit vlen 1.1 miliardë Euro, me investime në kompanitë startup që arrijnë në 67 milion Euro për periudhën 2020-2022. Nga ana tjetër, gjatë së njëjtës periudhë, ekosistemi Shqiptar nuk arriti të tërheqë investime, dhe rrjedhimisht pati një nivel të ulët të prodhimit cilësor të startup-eve. Në dy vitet e fundit, Fondi Shtetëror i Malit të Zi për Sipermarrjen ka arritur të shpërndajë

mbi 2.5 milionë Euro në grante direkte dhe asistencë teknike për fazat e fillimit të sipërmarrjeve, duke krijuar një mjedis të favorshëm ku fondet private mundësojnë plotësimin e investimeve shtetërore. Sot, po ashtu, vendi mund të numërojë mbi 9 milionë Euro si fonde kapitali privat për sipërmarrjet, të cilat janë në dispozicion për investime në ekosistemin e inovacionit.

Kapitali sipërmarrës inkurajon inovacionin dhe dinamizmin në botën e korporatave. Ky instrument financimi u ofron bizneseve opsione fleksibël, duke siguruar fonde për të mbështetur qëllimet e tyre të zgjerimit, për të krijuar sipërmarrje të reja dhe kreative, për të realizuar blerje të bizneseve të tjera ose për të ruajtur një balancë të qëndrueshme të kapitalit. Pavarësisht se është një mjet i kahershëm, Shqipëria nuk e ka parë ende zhvillimin e tij.

Ekonomia shqiptare kohët e fundit është mbështetur kryesisht në financimet bankare. Komuniteti i biznesit, prej disa vitesh, kërkon një diversifikim të burimeve të financimit. Ky diversifikim

konsiderohet si i favorshëm, pasi bën të mundur nxitjen e inovacionit dhe konkurrencës, forcimin e strukturave dhe kapitalit të korporatave, dhe lehtësimin e investimit të kapitalit afatgjatë në bizneset fillestare dhe krijuese.



Pronarët e bizneseve dhe startup-eve shqiptare duhet të fokusohen në rritjen e sipërmarrjeve të tyre, duke përdorur teknologjinë për të rritur prodhimin dhe efikasitetin, dhe duke synuar zgjerimin në tregun ndërkombëtar perpos atij vendas.

Edhe pse vitet e fundit kanë sjellë disa investime të profilizuara të biznesit, ka pak dëshmi të investimeve direkte nga këto grupe në kompani inovative dhe biznese të reja në Shqipëri. Niveli i përgjithshëm i investimeve është ende shumë i ulët në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, investimi përmes Kapitalit të Korporatave për Sipërmarrjen (CVC), një instrument që mbështet investimet në biznese të reja dhe K&Zh&I, i disponueshëm prej disa vitesh në rajon, ende nuk është zhvilluar në Shqipëri. Kjo mungesë krijon një hendek tjetër, ku kapitali privat mund të luajë një rol kyç si katalizator për zhvillimin e një ekosistemi inovativ dhe në rritje. Në rajon, rrjeti serb i investitorëve të biznesit ka siguruar kapital për startup-et serbe në fazat e tyre të hershme. Për më tepër, investitorët e biznesit në Maqedoninë e Veriut kanë mobilizuar mbi 1.5 milionë euro në sindikata investimesh vetëm gjatë vitit 2022, për t'u kanalizuar në të njëjtin segment. Sipas të dhënave të Start-up Genome dhe Dealroom, investimet

në startup-et shqiptare kanë qenë më pak se 1 milionë euro gjatë vitit 2021, vlerë kjo krahasimisht e ulët me vendet me përmasa të ngjashme në Evropë dhe pjesë të tjera të botës.

Së fundmi, aktivizimi i tregut alternativ të financave është thelbësor për suksesin e strategjive të inovacionit si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në ato në zhvillim. Krijimi i fondeve të investimeve, aktivizimi i rrjeteve të investitorëve të biznesit dhe ngritja e instrumenteve të Kapitalit të Korporatave për Sipërmarrjen (CVC) janë mënyra për të forcuar bashkëpunimin me ekosistemin e startup-eve. Megjithatë, është e pamjaftueshme për të bërë një ndryshim në ekosistemin shqiptar.

Masat për aktivizimin e kapitalit privat, së bashku me mbështetjen e financimit publik në fazat fillestare, do të ndikojnë pozitivisht në shtimin e numrit të startup-eve cilësore dhe sipërmarrësve ambiciozë. Instrumentet e strukturuar financiare të hartuara, të cilat synojnë faza të ndryshme të rritjes, duhet të zhvillohen me qëllim që strategjia të jetë e suksesshme. Për më tepër, angazhimi i palëve të interesuara në këtë mision duhet të koordinohet me kujdes, në mënyrë që grantet dhe instrumentet e tjera të menaxhohen siç duhet dhe t'u shpërndahen kompanive ose sipërmarrësve të duhur në fazat fillestare. Së fundmi, instrumentet e Kapitalit për Sipërmarrjen (VC) ose financimit të granteve janë thelbësore që sektori startup në fazat e hershme të rritet dhe të krijojë themelues elastikë që synojnë fazat e mëvonshme të rritjes, të tilla si vlefshmëria dhe aftësia për zgjerim.

Aftësimi për Zgjerim | Ngritja e kompanive për zhvillim



Shqipëria duhet të përgatisë ekosistemin e saj sipërmarrës dhe inovativ për anëtarësimin në BE, pasi madhësia e tregut do të zgjerohet në disa dimensione krahasuar me situatën aktuale.

Aftësia për zgjerim është e nevojshme për të siguruar krijimin e vendeve të punës, nxitjen e inovacionit dhe konsolidimin e industrive që nxisin ekonominë. Ajo gjithashtu mundëson eksplorimin e industrive të tjera, të cilat mund të integrohen. Sigurimi i burimeve të nevojshme për zgjerimin e kompanive duhet të ketë prioritet. Pronarët e bizneseve dhe startup-eve shqiptare duhet të fokusohen në rritjen e sipërmarrjeve të tyre, duke përdorur teknologjinë për të rritur prodhimin dhe efikasitetin, dhe duke synuar zgjerimin në tregun ndërkombëtar perpos atij vendas. Kjo do të mbështesë rritjen dhe aftësinë për zgjerim të bizneseve, duke i bërë ato më konkurruese.

Në Evropë, ekonomia e Shqipërisë është një ndër ekonomitë e varura nga NVM-të.¹⁶ Madhësia e tyre ndikon në produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e bizneseve të vogla gjatë cikleve të pafavorshme të biznesit. Përveç kësaj, ato përballen me vështirësi më të mëdha në sigurimin e fondeve krahasuar me bizneset më të mëdha.

Kompanitë të cilave u duhet të përmirësojnë konkurrueshmërinë dhe produktivitetin në Evropë dhe Shqipëri janë startup-et – kompanitë e sapokrijuara me një model biznesi inovativ, me aftësi zgjerimi, të bazuara në teknologji, të fokusuara në rritjen dhe përfitimin e shpejtë – dhe scaleup-et – që janë startup-et në një fazë rritjeje.

Teknologjia shihet të jetë thelbësore për ndërtimin e një kompanie me aftësi zgjerimi. Proçeset e krijuara nga startup-et janë të mundimshme dhe joefikase në fazat e hershme të testimit ose eksperimentimit. Sapo kalojnë këto faza, automatizimi dhe optimizimi përmes teknologjisë bëhen shpejt të domosdoshme. Çdo vit, evolucioni dixhital i BE-28 krahasohet duke u bazuar në Indeksin e Ekonomisë dhe Shoqërisë Dixhitale (DESI).¹⁷ Kur diskutohet aftësia e Shqipërisë për zgjerim, dy karakteristika relevante që shqyrtohen janë:

Shqipëria ka përmirësuar rezultatin e saj në dimensionin e lidhshmërisë krahasuar me vitet e mëparshme¹⁸, megjithëse ka ende potencial për përmirësim. Ky progres lidhet kryesisht me përhapjen e lidhjeve të shpejta të internetit, si ato fikse, ashtu edhe ato celulare.

Një element tjetër që përcakton kapacitetin e një biznesi për t'u rritur është tregu, ku bizneset, përmes teknologjisë, zgjerojnë shtrirjen e tyre dhe rrisin produktivitetin si pasojë e konkurrencës në tregut vendas. Për më tepër, zgjerimi i një kompanie përmes ndërkombëtarizimit do të jetë

çelësi për të përcaktuar nëse një biznes është i aftë për zgjerim dhe nëse do të mund të konkurrojë globalisht. Ndërmarrjet tradicionale të vogla dhe të mesme (NVM) prirën t'i japin përparësi diversitetit të tregut, por organizatat inovative ndihen më komode duke filluar në nivel global dhe duke i fokusuar përpjekjet e tyre për zgjerim në tregjet ndërkombëtare. Për të shfrytëzuar këtë tendencë, Shqipëria duhet të përgatisë ekosistemin e saj sipërmarrës dhe inovativ për anëtarësimin në BE, pasi madhësia e tregut do të zgjerohet në disa dimensione krahasuar me situatën aktuale. Nëse ky ekosistem zhvillohet mirë dhe lidhet efektivisht me ekosistemet e tjera të BE-së, ai mund të ofrojë mbështetje të rëndësishme për sipërmarrësit shqiptarë në aksesin e tyre në tregjet e hapura të BE-së.

Kjo strategji do të mundësojë arritjen e objektivit të aftësisë për zgjerim, duke përmirësuar mjedisin ekonomik, rritur konkurrencën dhe shfrytëzuar në maksimum mundësitë aktuale. Si rezultat, ajo do të mbështesë zgjerimin e iniciativave novatore dhe do të kontribuojë në suksesin e tyre tregtar.

Sektorët Nxitës

Siç u përmend më parë, shtylla e dytë e qasjes janë sektorët nxitës. Përveç mbështetjes për kontributet e institucioneve publike, korporative dhe akademike vendase dhe të huaja, ne duam të përdorim strategjinë tonë në gjashtë sektorë kyç. Këta sektorë ofrojnë një bazë për modernizimin dhe zgjerimin e ekosistemit tonë sipërmarrës, shërbejnë si hapësira kyçe për rinovimin e sistemit tonë ekonomik dhe ofrojnë mundësinë e domosdoshme për të rritur konkurrencën dhe produktivitetin duke krijuar teknologji dhe procese të reja.

Për të nxitur bashkëpunimin horizontal dhe vertikal brenda këtyre sektorëve, ne synojmë të përshpejtojmë krijimin e një fryme bashkëpunimi të nevojshme për zbatimin e kësaj strategjie. Ndërmarrjet njohura në të gjithë sektorët do të nxitin të angazhohen në iniciativë bashkëpunuese që promovojnë zhvillimin e industrisë dhe inovacionin. Do të inkurajohet bashkëpunimi mes bizneseve të mëdha dhe atyre të reja kreative, me qëllim ndarjen e avantazheve dhe krijimin e mundësive të reja përmes nismave të përbashkëta, zhvillimit të synuar të sipërmarrjes dhe financimit.

Arsyetimi kryesor për zgjedhjen e këtyre sektorëve është se inovacioni mund të ndikojë pozitivisht në ekonominë dhe shoqërinë në fusha ku Shqipëria është më mirë pozicionuar për të konkurruar në nivel global. Këto industri kombinojnë aftësitë e nevojshme për kombin tonë për t'u përshtatur me sfidat ndërkombëtare, duke hapur dyert për tregje, kompani dhe individë të rinj. Një ekonomi e larmishme, e cila gjeneron një numër dhe një cilësi më të lartë vendesh pune për përmirësimin e mirëqenies dhe cilësisë së jetës së njerëzve, do të forcohet për shkak të potencialit për transformim nëpërmjet inovacionit në fusha të ndryshme.



Figura 7. Sektorët strategjik prioritarë të ekonomisë shqiptare.

AGROBIZNESI - Një sektor me rëndësi jetike dhe një nga motorët kryesorë ekonomikë që siguron mbi 18% të PBB-së kombëtare. Bujqësia ende paraqet një burim kryesor të të ardhurave për popullsinë rurale dhe përbën 35% të punësimit total. Megjithatë, rritja e popullsisë rurale është negative (-3,5%), duke sfiduar sektorin e agrobiznesit.¹⁹

ENERGJIA - Një sektor që përfaqëson një shtyllë bazë për qëndrueshmërinë, ekonominë dhe mjedisin e vendit. Ai gjithashtu mund të aktivizojë dhe tërheqë korporata të mëdha dhe sasi të mëdha kapitali. Importet e energjisë në 20 vitet e fundit kanë variuar nga 12% në 54% të përdorimit të përgjithshëm kombëtar të energjisë, duke theksuar rëndësinë e zhvillimit të kapaciteteve kombëtare për prodhimin e energjisë.²⁰

AKTIVITETI PRODHUES - Një sektor industrial që ka ofruar mundësi punësimi për komunitete të mëdha, por shpesh me paga të ulëta. Ai ka potencialin të ndërtojë zinxhirin e vlerës, duke përdorur teknologji më të avancuara, automatizim të lartë dhe duke prodhuar produkte më të vlefshme që kërkojnë në tregje më të zhvilluara. Është një sektor me një normë pozitive rritjeje, që përfaqëson 7% të PBB-së kombëtare.²¹

BUSINESS PROCESS OUTSOURCING (BPO) - Nga këndvështrimi i kësaj strategjie, kjo përfshin një nën-segment të shërbimeve të palëve të treta të ofruara në teknologjinë e informacionit (shërbimet e mundësuar nga teknologjia e informacionit, ITES). ITES-i do të vazhdojë të ofrojë shumicën e punësimit në industrinë BPO. Sipas burimeve zyrtare, ITO përbënte 53% të gjithë punonjësve në Shqipëri në vitin 2018. Industria BPO kontribuoi me 2.1% të PBB-së së vendit në vitin 2018 dhe punësoi 5713 persona.²²

TIK-U - Sektori ekonomik me rritjen më të shpejtë në Republikë është teknologjia e informacionit (IT); segmenti më i madh është hardueri, i cili zë 55% të tregut, ndërsa segmenti i dytë më i madh është tregu i TIK-ut, me 30% të tregut, 15% e të cilit përbëhet nga softueri.

Disa prej përfitimeve të Shqipërisë përfshijnë një infrastrukturë të shkëlqyer, tatime të ulëta për personat juridikë dhe punëtorë shumë të kualifikuar me çmime të arsyeshme, si dhe një arsim të lidhur me TIK-un dhe njohuri të mira në anglisht. Industria po zgjerohet vazhdimisht dhe eksporton punëtorë të arsimuar në IT në vende të tjera.²²

TURIZMI - Ky sektor përfaqëson një prioritet strategjik për Shqipërinë, për shkak të peshës së tij gjithnjë në rritje në ekonominë kombëtare dhe rolin kyç në perceptimin ndërkombëtar të vendit. Gjatë viteve të fundit, udhëtimet dhe turizmi kanë kontribuar me 8,5-8,7% të PBB-së së Shqipërisë. Megjithatë, kur merren parasysh efektet e shumëfishta nga burime indirekte, kontributi i përgjithshëm pothuajse trefishohet, duke arritur mbi 20% të PBB-së. Kjo e bën sektorin një nga nxitësit kryesorë të zhvillimit ekonomik. Në vitin 2019, udhëtimet dhe turizmi kontribuan me 20% të PBB-së dhe krijuan 244,000 vende pune, duke u shndërruar në një motor të rëndësishëm ekonomik dhe një burim kryesor të punësimit. Sipas vlerësimeve të Këshillit Botëror të Turizmit dhe Udhëtimit, një në pesë vende pune në Shqipëri lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me turizmin dhe industrinë e lidhura me të.²³

NËN-SEKTORË, SEKTORË DHE SISTEME EKONOMIKE shitesë me potencial për zhvillim janë:

Ekonomia Blu

Ekonomia blu ka një vlerë prej 1,5 trilion dollarësh në vit.²⁴ Investimi në këtë sektor mund të nxisë mundësi të reja zhvillimi në nën-sektorë si peshkimi, turizmi bregdetar, energjia e rinovueshme, minierat në thellësi të detit dhe bioteknologjia.

Ushqim i Shëndetshëm

Fokusi në agrobiznes dhe industrinë ushqimore mund të përqëndrohet në nën-sektorët e ushqimit të shëndetshëm dhe MAP me potencial të lartë rritjeje. Këta nën-sektorë kërkojnë investime të shumta në arsimin e fuqisë punëtore dhe teknologji, por ofrojnë produkte me vlerë të shtuar më të lartë në krahasim me nën-sektorët e tjerë bujqësorë, duke krijuar mundësi të shkëlqyera për avancim në zinxhirin e vlerës përmes lidhjeve të ngushta me industrinë farmaceutike dhe ushqimore.

Energjia e Rinovueshme

Përqendrimi i sektorit të energjisë në energjinë e rinovueshme sjell rezultate të qëndrueshme dhe më efikase sesa burimet jo të rinovueshme. Konsumi i energjisë së rinovueshme në Shqipëri është tashmë 44% e konsumit total të energjisë, krahasuar me 20% të standardit botëror.²⁵ Ky avantazh duhet të ruhet përmes investimeve të fokusuara në burime të rinovueshme.

Nën-sektorë të tjerë të Business Process Outsourcing (BPO)

Përveç shërbimeve të aktivizuara nga teknologjia e informacionit në BPO, kjo strategji do të përfshijë shërbime të tjera BPO, të cilat kërkojnë aftësi më të larta dhe të specializuara për të ofruar shërbime me kompleksitet më të lartë biznesi (marketing, sektori kreativ, K&Zh), si dhe segmente të tjera të zinxhirit të vlerës së BPO, të lidhura me prodhimin dhe logjistikën. Kjo do të krijojë mundësi të rëndësishme për bashkëpunim mes akademisë dhe investitorëve.

Ekonomia e Gjelbër dhe Dixhitale

Sektori i gjelbër përfshin industri, aktivitete dhe inovacione që synojnë:

- » **Reduktimin e ndikimit mjedisor** përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve.
- » **Zvogëlimin e ndryshimeve klimatike** duke reduktuar emetimet e gazeve serrë dhe duke kaluar në burime të rinovueshme të energjisë.
- » **Promovimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese** si riciklimi, ripërdorimi i materialeve dhe minimizimi i mbetjeve.



Në Shqipëri, ne do të sigurojmë krijimin dhe matjen e çdo treguesi gjatë viteve të ardhshme, për të zhvilluar politika mbështetëse dhe ndërhyrje të qëndrueshme që do të kontribuojnë në avancimin e grave sipërmarrëse.

- » **Rikthimin e ekosistemeve** dhe nxitjen e biodiversitetit.

Sektori dixhital i referohet industrive dhe aktiviteteve të përqendruara në teknologji dhe inovacionin dixhital. Ai fokusohet në:

- » **Zhvillimin e infrastrukturës dixhitale**, përfshirë internetin me shpejtësi të lartë, rrjetet 5G dhe shërbimet cloud.
- » **Industritë e bazuara në të dhëna** që shfrytëzojnë inteligjencën artificiale (AI), të dhëna të mëdha, big data dhe machine learning.
- » **Transformimin dixhital** të industrive tradicionale, duke rritur produktivitetin dhe konkurrencën.
- » **Nxitjen e ekosistemeve inovative**, përfshirë startup-et dhe bizneset e teknologjisë.

NEVOJAT DHE HENDEQET HORIZONTALE

Sipas Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm të miratuar nga OKB-ja në vitin 2015, Strategjia e Sipërmarrjes dhe misioni kombëtar i Shqipërisë do të jenë të qëndrueshme për sa i përket kohës dhe burimeve. Si e tillë, ajo do të krijojë mundësinë që segmente të ndryshme të shoqërisë të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, të përfitojnë nga mbështetja e qeverisë dhe të nxisin transformimin në komunitete dhe rajone të ndryshme.

Sipërmarrja nga Gratë

Zhvillimi i talentit femëror është një iniciativë e strategjizuar për të kontribuar në mirëqenien e shoqërisë në tërësi. Për sa i përket sipërmarrjes kreative, ku çdo mundësi rritjeje duhet shfrytëzuar, zhvillimi i krijimtarisë duhet të orientohet drejt krijimit të sipërmarrjeve tregtare të qëndrueshme dhe një kuadri ekonomik më të larmishëm. Burrat dhe gratë sipërmarrëse mund të kenë një gamë të gjerë qëllimesh, siç dëshmohet nga zgjidhjet e ndryshme që sipërmarrja krijuese mund t'u ofrojë kërkesave emergjente, duke rritur gjasat që projektet të zhvillohen me sukses.

Global Entrepreneurship Monitor, një vëzhgues global i sipërmarrjes që studion dinamikën e sipërmarrjes në 50 shtete, raporton se vetëm gjashtë vende kanë norma të ngjashme sipërmarrjeje midis burrave dhe grave (2019-2020). Mesatarja evropiane është vetëm gjashtë gra për çdo dhjetë sipërmarrës meshkuj.²⁶ Në Shqipëri, ne do të sigurojmë krijimin dhe matjen e çdo treguesi gjatë viteve të ardhshme, për të zhvilluar politika mbështetëse dhe ndërhyrje të qëndrueshme që do të kontribuojnë në avancimin e grave sipërmarrëse.

Të dhënat e Pitchbook tregojnë se në dhjetë vitet e fundit, numri i startup-eve të themeluara nga gratë është katërfishuar globalisht, dhe midis 2010 dhe 2018, sasia e parave të investuara nga gratë është katërfishuar gjithashtu. Për më tepër, një tregues vendimtar i performancës së tyre ishte se startup-et me të paktën një grua mundën të arrinin shitjen në 6.4 vite, krahasuar me 7.4 vite në ras-

tet e tjera. Po ashtu, startup-et e udhëhequra nga gratë kishin një shkallë më të ulët dështimi sesa ato të drejtuar nga burrat, me 22% kundrejt 51%.²⁷

Inkurajimi i sipërmarrjes së grave ofron një mundësi për të ndërtuar biznese që maksimizojnë potencialin e të gjithë individëve, duke kontribuar njëkohësisht në arritjen e barazisë gjinore. Përveç krijimit të një mjedisi më inovativ, një model biznesi që vlerëson diversitetin do të përfitojë nga pikëpamjet plotësuese dhe alternative që pasqyrojnë më mirë realitetet e kontekstit shoqëror, duke e bërë atë më konkurrues dhe duke rritur gjasat për suksesin e startup-eve.



Qendrat Rajonale të Transformimit dhe Parqet Teknologjike do të ofrojnë mbështetje për komunitetet përtej kryeqytetit dhe qyteteve të mëdha, duke qenë të aksesueshme për zonat rurale, ku sipërmarrja inovative mund të mbështetet më tej përmes shërbimeve të tyre.

Përfshirja e Brezave

I referohet pabarazisë në moshë, që është shpesh më e theksuar tek individët më të moshuar, por prek edhe të rinjtë.

Rritja e jetëgjatësisë është një realitet global. Sipas parashikimeve të OKB-së, përqindja e personave mbi 65 vjeç do të rritet nga 6% në 2019 në 16% në 2050.²⁸ Sipas INSTAT-it, moshë mesatare e popullsisë shqiptare është rritur nga afro 33 vjeç në 1 janar 2011 në 38 vjeç, në 1 janar 2022. Gjatë kësaj periudhe, moshë mesatare e popullsisë është rritur gjithashtu për meshkujt, nga 31.3 në 37.3 vjeç, dhe për gratë, nga 33.9 në 39.1 vjeç.²⁹

Popullsia e Shqipërisë po rritet në moshë. Kjo tregohet nga përqindja e popullsisë mbi 65 vjeç, krahasuar me popullsinë nën 15 vjeç nga 2011 në 2022.

» Grupi i moshës 0-14 vjeç është ulur nga 21,6 % në 2011 në 16,3 % në 2022.

» Grupi i moshës 15-64 vjeç është rritur nga 67,4% në 2011 në 68,0% në 2022.

» Grupi i moshës 65+ është rritur nga 11,0 % në 2011 në 15,7 % në 2022.

Asnjë sektor i shoqërisë së sotme, nga profesionistët tek qytetarët, nuk mbetet i paprekur nga procesi i transformimit të drejtuar nga revolucioni dixhital. Në sferat profesionale, sipas OECD's Getting Skills Right: Future-Ready Adult Learning Systems (2019), 32% e punëve të analizuar globalisht do të pësojnë ndryshime të mëdha, dhe 14% do të bëhen plotësisht të automatizuara. Për më tepër, vetëm 41% e punonjësve të rritur i nënshtrohen trajnimit profesional çdo vit për zhvillimin e karrierës së tyre. Në të 32 vendet e analizuar, do të kërkojnë ndryshime organizative dhe investime në kapitalin njerëzor.³⁰ Përshtatja me këtë mjedis të ri pune do të paraqesë një sfidë të dukshme për individë të caktuar, veçanërisht për profesionistët e rritur.

Siç tregohet nga shumë programe mentorimi për sipërmarrësit e rinj, sipërmarrësit me eksperiencë janë një pasuri e madhe në ofrimin e mentorimit dhe shtimin e vlerës për ekipet më të reja përmes

njohurive dhe qasjes së tyre. Ata shpesh udhëheqin iniciativa biznesi që adresojnë nevojat e popullsisë së moshuar, duke kontribuar në inovacionin social dhe duke ofruar përfitime për shoqërinë.³¹ Ky studim thekson gjithashtu se sipërmarrja e pjekur ofron një zgjidhje të rëndësishme politike dhe ekonomike për pasojat e plakjes së popullsisë në Europë. OECD-ja inkurajon zhvillimin e sipërmarrjes së konsoliduar, duke ofruar një mjedis dhe strukturë mbështetëse për sipërmarrësit me eksperiencë.³²

Së fundmi, një koncept i ekonomisë së konsoliduar, i promovuar nga Instituti Global për Sipërmarrjen me Eksperiencë në Monitorin e tij Global të Sipërmarrjes, tregon se 70% e bizneseve të themeluara nga sipërmarrës të pjekur vazhdojnë të operojnë deri në pesë vite pas krijimit të tyre, krahasuar me vetëm 28% të bizneseve të themeluara nga sipërmarrës të rinj.³³

Pabarazia Rajonale dhe Rurale


Vendi i origjinës ose vendbanimi i individëve krijon një pikë të konsiderueshme pabarazie.

Trajtimi i pabarazisë territoriale përfshin më shumë sesa rigjallërimin e zonave rurale; ai përfshin ringjalljen e atyre zonave gjeografike që përballen me sfida që vijnë nga nivelet e ulëta të lindjeve, humbja e popullsisë dhe talenteve, si dhe ngadalësimi ose ndërprerja e aktivitetit ekonomik, ndërmjet faktorëve të tjerë. Është thelbësore që në këto zona të mbështeten përpjekjet që synojnë balancimin e të ardhurave dhe popullsisë, ose krijimin e mundësive për të lejuar individët të zgjedhin lirisht vendbanimin e tyre.

Sigurimi i prosperitetit në të gjithë territorin kombëtar është një prioritet thelbësor për çdo qeveri. Çështjet kryesore me të cilat përballlet çdo rajon përfshijnë modernizimin dhe zhvillimin e sektorëve ekonomikë, garantimin e lidhjes infrastrukturore dhe dixhitale, minimizimin e ndarjes teknologjike dhe nxitjen e sipërmarrjes. Përhapja e punës në distancë dhe mësimi online, veçanërisht e përsheptuar nga kriza shëndetësore e COVID-19, ka theksuar rëndësinë e këtyre sfidave dhe ka nxitur diskutime për zgjidhje të qëndrueshme. Në këtë kontekst, sipërmarrja shfaqet si një forcë kyçe për zhvillimin dhe përparimin shoqëror.

Për të adresuar nevojat e zonave rurale, Qendrat Rajonale të Transformimit dhe Parqet Teknologjike do të ofrojnë mbështetje për komunitetet përtej kryeqytetit dhe qyteteve të mëdha, duke qenë të aksesueshme për zonat rurale. Këto qendra do të luajnë një rol kyç në nxitjen e sipërmarrjes inovative përmes shërbimeve të tyre të specializuara. Përvoja ka treguar se shfrytëzimi i burimeve lokale jo vetëm që stimulon aktivitetin ekonomik dhe fuqizon sipërmarrjen, por gjithashtu identifikon dhe promovon talentin vendas. Njëkohësisht, kjo qasje kontribuon në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore e historike, veçanërisht në kontekstin rural.

MASAT PËR KRIJIMIN E NJË EKOSISTEMI TË HAPUR TË SIPËRMARRJES SË INOVACIONIT.



Strategjia Kombëtare për Sipërmarrjen propozon zbatimin e një sërë masash nga institucionet shtetërore. Këto masa krijojnë një bazë të fortë për ta bërë inovacionin një fenomen ndërsektorial të integruar në sektorët kyç të ekonomisë. Ato janë të orientuara drejt arritjes së katër objektivave të propozuara në kuadër të strategjisë: zhvillimi i ekosistemit sipërmarrës të inovacionit, tërheqja, zhvillimi dhe mbajtja e talentëve, përsheptimi i ciklit të investimeve dhe mbështetja e aftësisë për zgjerim.

Çdo masë dhe grup masash shërben si një udhëzues strategjik për aktorët publikë dhe privatë, duke i orientuar ata drejt përbushjes së objektivave të përcaktuara në këtë strategji, e cila përbën një prioritet në agjendën politike të vendit tonë.

Masat Prioritare

Objektivi: Përmirësimi, konsolidimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i Agjencisë Startup Albania, për rritje të qëndrueshme dhe efektive në përbushjen e objektivave ligjore dhe strategjike.

Përmirësimi, konsolidimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i një subjekti përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e shërbimeve mbështetëse të sipërmarrjes në bashkëpunim me çdo organizatë shtetërore dhe aktorë të tjerë publik dhe privat brenda ekosistemit. Startup Albania do të mbështetet nga institucionet publike, organizatat ndërkombëtare dhe subjektet e tjera, duke synuar shtrirje në nivel kombëtar dhe përfshirjen e fondeve ndërkombëtare si dhe të diasporës. Rolet kryesore të agjencisë janë:

Rezultatet:

- » Krijimi i një pike qendrore informacioni dhe asistence për sipërmarrjen inovative në Shqipëri. Startup Albania do të shërbejë si burimi kryesor i informacionit për çdo individ, kompani dhe institucion të interesuar në ekosistemin e sipërmarrjes. Agjencia do të luajë një rol kyç në mbështetjen e proceseve komplekse ndërkombëtare, siç është aplikimi për financime evropiane, duke ofruar udhëzim dhe ndihmë të specializuar.
- » Përpilimi dhe shpërndarja e një biblioteke burimesh për investitorët dhe bizneset. Agjencia do të strukturojë dhe organizojë në mënyrë efektive të gjitha masat mbështetëse për sipërmarrjet, duke lehtësuar aksesin në informacion dhe identifikimin e fushave për përmirësim. Një sistem itinerarësh të personalizuar, i përshtatur për nevojat specifike të çdo përdoruesi, do të vihet në dispozicion për të ofruar një përvojë të optimizuar dhe efektive.
- » Krijimi i një shërbimi që u mundëson kompanive të përfitojnë sa më shumë nga mjetet dhe instrumentet e financimit ndërkombëtar të disponueshëm për projekte inovative. Synimi do të jetë maksimizimi i fitimeve nga këto burime për Shqipërinë.
- » Koordinimi dhe menaxhimi i Pikave të Informacionit të Sipërmarrjes në universitete.
- » Promovimi i historive të suksesit dhe mbështetja e tyre publikisht. Vazhdimi i promovimit të imazhit pozitiv të sipërmarrësve sot, dhe puna drejt ndryshimit të perceptimit social mbi

dështimet në biznes, në mënyrë që këto të fundit të perceptohen si një eksperiencë kalitëse ose si një mundësi mësimi në të ardhmen.

- » Krijimi i Observatorit të Sipërmarrjes për të monitoruar dhe matur evolucionin e ekosistemit sipërmarrës, duke hartuar raporte të detajuara dhe duke ofruar rekomandime konkrete për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe identifikimin e mundësive për rritje.
- » Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i skemave të financimit publik dhe privat të ekosistemit të sipërmarrjes.
- » Ndërtimi i programeve që mbështesin sipërmarrësit dhe aktorët e tjerë të ekosistemit me kapacitet teknik.
- » Bashkëveprimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare për të përmirësuar instrumentet e financimit për ekosistemin shqiptar.
- » Zhvillimi dhe zbatimi i programeve në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, me fokus në iniciativa specifike gjinore.
- » Ofrimi i shërbimeve për regjistrimin dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale, duke ndihmuar startup-et në sigurimin e të drejtave të tyre ligjore dhe mbrojtjen e inovacioneve.

Grupet e synuara:

Niveli Macro

Objektivi: Ngritja e qeverisjes së ekosistemit dhe koordinimi dhe harmonizimi i angazhimit të palëve të interesuara.

Në kuadrin e qeverisjes së ekosistemit, roli kryesor i Agjencisë Shtetërore Startup Albania do të jetë bashkërendimi dhe përafrimi i angazhimit të palëve të interesuara. Në një strukturë kaq komplekse, duhet të ndërtohen kapacitetet operationale të Agjencisë, duke e lejuar atë të kryejë të gjitha operationet dhe aktivitetet e parashikuara, të menaxhojë infrastrukturën dhe të ofrojë mbështetje për aktorët e ekosistemit. Si pjesë e strukturës komplekse të qeverisjes, Agjencia Startup Albania do të kryejë përpjekjet koordinuese në nivel operacional, dhe Ministri përgjegjës për Sipërmarrjen në nivel politik.

Koordinimi do të përfshijë lehtësuesit dhe organet zbatuese që operojnë brenda ekosistemit, investitorët dhe kompanitë e sektorit privat. Ai do të zhvillojë instrumente dhe programe që mundësojnë angazhimin efektiv të çdo aktori në mbështetjen e sipërmarrjes, duke siguruar rezultate maksimale në përputhje me objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të përcaktuara në këtë dokument strategjik. Ky proces synon të adresojë fragmentimin dhe rrjedhjet brenda ekosistemit, të nxisë sinergjitë ndërmjet aktorëve dhe të zgjerojë shtrirjen e sipërmarrësve në të gjithë territorin e Shqipërisë. Duke pasur parasysh ndikimin e akademisë, diasporës dhe sipërmarrjes femërore në ekonominë shqiptare, aktivitetet e kësaj strategjie do të marrin në konsideratë interesin e veçantë të secilit grup.

Së fundmi, për të siguruar arritjen e këtij objektiivi operacional, Agjencia do të zhvillojë shërbime të

dedikuara për grupe të veçanta të interesit dhe do t'i ofrojë ato përmes infrastrukturës ekzistuese të ekosistemit. Gjithashtu, Agjencia do të propozojë përmirësime në modelin e qeverisjes së ekosistemit.

Rezultatet:

- » Modeli i qeverisjes – Siç përshkruhet në kapitullin Qeverisja e Strategjisë, modeli i qeverisjes do të zbatohet për të lejuar qeverisjen efektive të ekosistemit. Asistenca teknike në zbatimin e modelit të qeverisjes të parashikuar nga Strategjia do të jetë e nevojshme.
- » Monitorimi dhe propozimi i përmirësimeve për modelin dhe strategjinë e qeverisjes – Si masë afatgjatë, mekanizmat e monitorimit dhe përmirësimit do të propozohen si pjesë e modelit të qeverisjes.

Grupet e synuara:

Niveli makro

Hartimi dhe diagnostikimi i vazhdueshëm i ekosistemit dhe programet e rritjes.

Objekti: Hartimi i palëve të interesuara dhe diagnostikimi i nevojave të aktorëve kryesorë të ekosistemit.

Rezultatet:

- » Baza e të dhënave të palëve të interesuara – Një komponent kyç i planit të zhvillimit të ekosistemit, që mundëson komunikim efikas, diagnostikimin e ekosistemit dhe koordinimin e veprimeve ndërmjet të gjitha palëve të interesuara. Krijimi i një baze të dhënash unike për të gjithë aktorët përkatës do të adoptojë një qasje të shumëfishtë, duke bërë dallimin midis aktorëve mikro, mezzo dhe makro si bazë për klasifikim. Gjithashtu, ajo do të mundësojë gjeolokimin e aktorëve dhe do të ofrojë një kuptim më të thellë të grupimeve të aktorëve të veçantë brenda territorit të Shqipërisë.
- » Procesi diagnostikues – Vendosja e procesit diagnostikues do të mundësojë ndjekjen e vazhdueshme të zhvillimit të ekosistemit duke mbledhur të dhëna për palët e interesuara, aktivitetet e tyre, marrëdhëniet, komplementaritetin dhe nevojat. Mekanizmi i hartës dhe diagnostikimit do të ofrojë një pasqyrë të qartë të ekosistemit, duke mundësuar përmirësime në nivelet e qeverisjes dhe aktivitetit. Pjesa diagnostike përfshin mbledhjen e burimeve parësore (anketime, intervista) dhe burimeve dytësore të të dhënave (të dhëna statistikore të përmbledhura, burime të tjera dytësore). Diagnostifikimi i ekosistemit do të publikohet si një studim periodik (vjetor).
- » Procesi i hartëzimit dhe diagnostikimit të vazhdueshëm – Një proces afatgjatë dhe i vazhdueshëm (vjetor) që përqendrohet në përmirësimin e vazhdueshëm të bazave të të dhënave të palëve të interesuara dhe diagnostikimin e nevojave të tyre.

Grupet e synuara

Niveli makro, mikro dhe mezzo

Realizimi i aftësisë për zgjerim përmes infrastrukturës së hapur të inovacionit, si fizike ashtu edhe virtuale.

Objektivi: Krijimi i një rrjeti të standardizuar të inkubatorëve publikë dhe privatë, përshpejtuesve, ndërtuesve të sipërmarrjeve dhe një përzierje sektoriale publik-privat.

Në këtë rrjet, sipërmarrja dhe inovacioni inkurajohen në të gjithë territorin kombëtar. Rezultati do të eliminojë hendekun territorial dhe do të shumëfishojë kapacitetin sipërmarrës të vendit. Një markë specifike do të projektohet për të ofruar kredenciale dhe informacion në lidhje me cilësinë e shërbimit për anëtarët e rrjetit.

Infrastruktura do të përdorë korniza të favorshme rregullatore, do të mundësojë një mjedis të hapur inovacioni dhe do të punojë për të promovuar sipërmarrje inovative brenda dhe jashtë vendit. Infrastruktura e inovacionit do të adresojë fragmentimin dhe do të sigurojë mbështetje të jashtme për ekosistemin shqiptar të sipërmarrjes, duke shfrytëzuar plotësisht mandatin, përvojën dhe aftësitë e saj operacionale.

Rezultatet:

- » Përdorimi i mekanizmave të qeverisjes – Qeverisja e ekosistemit do të përdorë një qasje shumëministrorë për të shfrytëzuar kornizat e favorshme rregullatore, për të mundësuar një mjedis të hapur inovacioni dhe për të promovuar sipërmarrjen inovative brenda dhe jashtë vendit. Infrastruktura e inovacionit do të adresojë fragmentimin dhe do të sigurojë mbështetje të jashtme për ekosistemin shqiptar të sipërmarrjes, duke shfrytëzuar plotësisht mandatin, përvojën dhe aftësitë e saj operacionale. Në nivel praktik, do të jetë e nevojshme përgatitja e një modeli biznesi për qeverisjen e infrastrukturës së hapur të inovacionit, duke përfshirë Parqet Teknologjike, Qendrat Rajonale të Transformimit, Qendrat e Inovacionit Dixhital, komunitetet inteligjente dhe laboratorët e gjallë, të cilët kontribuojnë në inovacionin fillestar. Gjithashtu, do të kërkohet përgatitja për investime në ngritjen e projekteve infrastrukturore të inovacionit të hapur në bashkëpunim me pushtetin vendor.
- » Krijimi i një rrjeti inkubatorësh – Duke zhvilluar programe të para-inkubacionit, inkubacionit dhe certifikimit të tyre, inkubatorët do të ofrojnë shërbime dhe mbështetje më efektive për startup-et.
- » Përgatitja dhe ekzekutimi i granteve për inkubatorët – Fokusimi në inkubatorët me bazë universitare dhe komercializimi i projekteve kërkimore.

Grupet e synuara

Niveli makro, mikro dhe mezzo

Qendrat Rajonale të Transformimit dhe Parku Teknologjik.

Objektivi: Rrjeti do të përfshijë Qendrat Rajonale të Transformimit dhe Parqet Teknologjike.

Rolet e kësaj infrastrukture do të jenë:

- » Ndarja e njohurive dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjithë anëtarëve.
- » Organizimi i aktiviteteve lokale, seminareve dhe takimeve për të nxitur ekosistemin.
- » Ofrimi i shërbimeve të inkubacionit dhe përsheptimit për kompanitë inovative. Këto shërbime mund të përfshijnë, ndër të tjera, kërkimin dhe analizën e tregut, ofrimin e infrastrukturës teknologjike si dhe udhëzimin dhe mentorimin për sigurimin e investimeve.
- » Inkurajimi i iniciativave të trajnimit për zhvillimin dhe rikualifikimin e aftësive, veçanërisht në teknologjitë novatore, qasjet e inovacionit dhe rritjes dhe aftësitë dixhitale.
- » Inkurajimi i inovacionit duke ofruar akses në mjetet më të fundit dhe duke transferuar teknologji.
- » Puna me bizneset e mëdha për të krijuar një prani brenda qendrave të rrjetit dhe mbështetja në këto fusha për të rekrutuar dhe tërhequr talente, për të prodhuar inovacion të hapur dhe për të ofruar produkte dhe shërbime.
- » Zbatimi i iniciativave që synojnë zhvillimin, tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve.
- » Ndërtimi i aftësisë së brendshme investuese dhe organizimi dhe inkurajimi i rrjeteve lokale të investimeve private.

Rezultatet:

- » Krijimi i infrastrukturës dhe ambjentit inovator në ndihmë të sipërmarrjes.

Platforma dixhitale.

Objektivi: Krijimi i një mjedisi virtual që ofron të njëjtat shërbime të disponueshme në hapësirën fizike, në mënyrë që të synohen më shumë sipërmarrës ruralë dhe t'u sigurohen atyre mundësi të barabarta.

Platformat do të përmbajnë:

- » Kurrikula të verifikuara dhe mjete dixhitale për mësimin elektronik.
- » Sesione të dedikuara mentorimi dhe trajnimit.
- » Instrumente rrjetëzimi.
- » Instrumente prezantimi.
- » Matricat e zhvillimit (TRL, veçoritë organizative, etj.).
- » Lidhjet me platformat ndërkombëtare.
- » Mundësi për të marrë pjesë në ngjarje dhe samite ndërkombëtare.
- » Aplikacionin celular.
- » Programe aftësish të dedikuara për të gjitha fazat e sipërmarrjes.

Grupet e Synuara:

Micro dhe Mezzo

Ndërtimi i instrumenteve të financimit.

Objektivi: Identifikimi i nevojave për financim dhe për të ndërtuar instrumente adekuate financimi që synojnë të mbështesin startup-et dhe aktorët e ekosistemit të sipërmarrjes.

Që ekosistemi të shfrytëzojë në mënyrë optimale infrastrukturën e inovacionit dhe mjetet dixhitale, një grup kompleks masash do të përfshijë:

- » Miratimi i një kuadri legjislativ mbështetës për sipërmarrjen, i cili, ndër të tjera, krijon një autoritet ligjor që inkurajon rritjen dhe tërheq kapitalin në këtë industri.
- » Forcimi i mekanizmave të investimeve publike dhe private.
- » Forcimi i rolit të sektorit publik si katalizator për investime me ndikim. Kjo do të bëhet përmes zhvillimit të një strategjie në përputhje me ato ekzistuese në vende të tjera si Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Estonia, edhe përmes mobilizimit të fondeve publike. Këto fonde publike do të synojnë të rrisin ose të orientojnë investimet dhe financimin aktual drejt projekteve të trefishta që kanë potencial për ndikim.
- » Nxitja e investimeve private, duke inkurajuar përfshirjen e investimeve me ndikim në fushat e Përgjegjësisë Sociale të Korporatës (CSR). Kjo do të promovojë mobilizimin e fondeve të korporatave drejt investimeve me ndikim social.
- » Aktivizimi i Kapitalit për Sipërmarrjen (VC) përmes partneriteteve publiko-private dhe programeve të dedikuara për sipërmarrësit shqiptarë.
- » Krijimi i një instrumenti të ri financiar që siguron financim për tre faza të zhvillimit të startup-eve.
- » Lehtësimi i programeve të trajnimit për investitorët lokalë të biznesit.
- » Ndërtimi i standardeve për programet e inkubacionit dhe përsheptimit.
- » Krijimi i programeve për tre fazat e zhvillimit të startup-eve.
- » Mbështetja e aktorëve të ekosistemit.

Grupet e synuara:

Ëngjëjt e biznesit, fonde të investimit të kapitalit, aktorët e niveleve mikro, mezzo dhe makro

Tërheqja e fondeve ndërkombëtare dhe investitorëve nga diaspora.

Objektivi: Rritja e angazhimit të fondeve ndërkombëtare dhe diasporës në ekosistemin e sipërmarrjes shqiptare.

Kjo do të nxisë krijimin e lidhjeve produktive midis aktorëve të ekosistemit, brenda dhe jashtë vendit, dhe do të rrisë atraktivitetin e ekosistemit shqiptar për themeluesit dhe kapitalin ndërkombëtar.

Rezultatet:

- » Zhvillimi i masave për tërheqjen e fondeve të diasporës dhe ndërkombëtare nëpërmjet mjeteve të qeverisjes – Megjithëse disa shtete, si Estonia, mund të ofrojnë sisteme tatimore më të favorshme, Shqipëria mund ta kompensojë me kosto më të ulëta të punës, punëtorë të talentuar dhe me arsim të lartë dhe një potencial të pazbuluar në sektorë të caktuar të industrisë.
- » Fushata komunikuese për ekosistemin e sipërmarrjes – Për të rritur angazhimin e fondeve ndërkombëtare dhe të diasporës, është e nevojshme të zhvillohet ndërgjegjësimi për mundësitë ekzistuese dhe të ardhshme në grupet e synuara të investitorëve ndërkombëtarë dhe të diasporës. Plani i komunikimit do të shfrytëzojë kanalet e komunikimit dixhital, duke maksimizuar shtrirjen e tij përmes platformës dixhitale që parashikohet të ndërtohet si pjesë e këtij plani. Gjithashtu, programet përshpejtuese të BE-së dhe vendeve anëtare të saj do të promovohen për të rritur dukshmërinë e fondeve ndërkombëtare për startup-et shqiptare. Kjo është një masë afatgjatë që kërkon angazhimin e të gjitha palëve të interesuara.
- » Rritja e veprimit të hartës dhe diagnostikimit me diasporën dhe të dhënat e palëve të interesuara të fondeve ndërkombëtare – Për të ndërtuar marrëdhënie të forta me fondet ndërkombëtare dhe diasporën, do të jetë e nevojshme të përmirësohet hartëzimi dhe diagnostikimi i ekosistemit, duke përdorur të dhënat e rrjetit të diasporës dhe palëve të interesuara të fondeve ndërkombëtare.

Grupet e synuara

Rrjeti financiar vendas dhe ndërkombëtar, shtresa mikro dhe mezo

Sektorët e ndryshëm të vendit tonë ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për të tërhequr themeluesit ndërkombëtarë për të ngritur startup-et e tyre këtu. Megjithëse disa shtete, si Estonia, mund të ofrojnë sisteme tatimore më të favorshme, Shqipëria mund ta kompensojë me kosto më të ulëta të punës, punëtorë të talentuar dhe me arsim të lartë dhe një potencial të pazbuluar në sektorë të caktuar të industrisë.

Për të shtuar përfshirjen e fondeve ndërkombëtare dhe të diasporës, duhet të zhvillohet ndërgjegjësimi për mundësitë ekzistuese dhe të ardhshme në grupet e synuara të investitorëve ndërkombëtarë dhe të diasporës. Për të ndërtuar marrëdhënie të forta me fondet ndërkombëtare dhe diasporën, si hap i parë, do të jetë e nevojshme të përmirësohet hartëzimi dhe diagnostikimi i ekosistemit me bazën e të dhënave të rrjetit të diasporës dhe fondeve ndërkombëtare. Objektivi kryesor i këtij veprimi është integrimi i fondeve të diasporës dhe atyre ndërkombëtare në të gjitha aktivitetet e parashikuara dhe nxitja e krijimit të lidhjeve ndërmjet palëve të interesuara brenda dhe jashtë vendit.

Për më tepër, plani i marketingut dhe komunikimit për këto grupe të synuara do të shfrytëzojë kanalet e komunikimit dixhital, duke maksimizuar shtrirjen e tij përmes platformës dixhitale që parashikohet të ndërtohet si pjesë e këtij plani.

Zhvillimi dhe financimi i zgjidhjeve me fokus të gjelbër dhe dixhital në ekonomi.

Objektivi: Krijimi i zgjidhjeve nga startup-et shqiptare, të cilat fokusohen në zhvillimin e qasjeve të gjelbra dhe dixhitale për ekonominë vendase dhe globale.

Për të shtuar përfshirjen e zgjidhjeve të gjelbra dhe dixhitale nga startup-et, duhet të zhvillohet ndërgjegjësimi për mundësitë ekzistuese dhe të ardhshme në grupet e synuara të investitorëve ndërkombëtarë dhe të diasporës. Për të ndërtuar marrëdhënie të forta me fondet ndërkombëtare dhe diasporën, si hap i parë, do të jetë e nevojshme të përmirësohet hartëzimi dhe diagnostikimi i ekosistemit me bazën e të dhënave të rrjetit të diasporës dhe fondeve ndërkombëtare. Objektivi kryesor i këtij veprimi është integrimi i zgjidhjeve të gjelbra dhe dixhitale nga diaspora dhe fondet ndërkombëtare në të gjitha aktivitetet e parashikuara dhe nxitja e krijimit të lidhjeve ndërmjet palëve të interesuara brenda dhe jashtë vendit.

Në këtë kontekst, do të merren masa konkrete përmes financimit dhe asistencës teknike, duke përfshirë krijimin e fondeve të posaçme për mbështetjen e startup-eve të gjelbra dhe dixhitale, ofrimin e granteve për zhvillimin e teknologjive të qëndrueshme, si dhe sigurimin e asistencës teknike për përmirësimin e kapaciteteve të tyre. Për më tepër, plani i marketingut dhe komunikimit për këto grupe të synuara do të shfrytëzojë kanalet e komunikimit dixhital, duke maksimizuar shtrirjen e tij përmes platformës dixhitale “One Stop Shop” që parashikohet të ndërtohet si pjesë e këtij plani.

Rezultatet:

- » Mbështetja e 10 ekipeve përmes asistencës teknike dhe financiare për komercializimin e zgjidhjeve teknologjike. Mbështetja e 5 inkubatorëve me fokus në zgjidhjet e gjelbra dhe dixhitale, përmes financimit, rrjetëzimit, asistencës teknike dhe ndërkombëtarizimit.

Grupet e synuara:

Shtresat mikro, mezzo dhe makro, universitetet dhe rrjetet akademike

Krijimi i një reputacioni ndërkombëtar pozitiv për ekosistemin e sipërmarrjes.

Objektivi: Rritja e perceptimit pozitiv për ekosistemin shqiptar të sipërmarrjes, përmes zhvillimit të markës së ekosistemit dhe strategjisë së komunikimit.

Kjo strategji parashikon zhvillimin e një plani për identitetin e markës, marketingun dhe komunikimin, me fokus në promovimin ndërkombëtar të ekosistemit sipërmarrës shqiptar, si dhe zhvillimin e markave dhe certifikatave të cilësisë për produktet dhe shërbimet.

Reputacioni duhet të krijohet rreth markës kombëtare që përfaqëson të gjitha përpjekjet krijuese të lidhura me sipërmarrjen. Menaxhimi i reputacionit të ekosistemit është një proces kompleks, i cili varet nga shumë faktorë variabël, disa prej të cilëve kanë një dimension historik dhe kërkojnë vëmendje të veçantë. Shqipëria është një vend modern, në rritje dhe zhvillim të shpejtë, i orientuar drejt krijimit të një ekonomie të bazuar në njohuri, që ndan vlera dhe tregje me disa nga ekonomitë më të zhvilluara të botës. Prandaj, ekosistemi sipërmarrës shqiptar ka nevojë për një markë që ta lidhi me një mesazh të tillë.

Marka do të përfaqësojë identitetin e një shoqërie shqiptare me aftësi sipërmarrëse dhe do ta pozicionojë Shqipërinë si një vend tërheqës në mbarë botën për investime, jetesë dhe ngritjen e sipërmarrjeve. Ajo gjithashtu do të theksojë kohezionin midis aktorëve të ekosistemit kombëtar shqiptar nga Shqipëria dhe jashtë saj. Një komponent kyç në ndërtimin e markës së ekosistemit sipërmarrës, të bazuar në njohuri, është diaspora, e përfaqësuar nga sipërmarrësit shqiptarë me arsim të lartë që jetojnë jashtë vendit, dhe mjedisi akademik kombëtar. Po ashtu, tregjet dhe rrjetet financiare, si ato kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, do të luajnë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e kredibilitetit për ekosistemin shqiptar të sipërmarrjes, përmes projekteve të ndryshme.

Strategjia e ndërtimit të markës do të fokusohet në promovimin e zhvillimit ekonomik, social, mjedisor dhe gjithëpërfshirës. Ajo do të synojë të rrisë ndërgjegjësimin për ndikimin pozitiv ndërmjet të gjitha niveleve të ekosistemit, duke përfshirë ato makro, të mesme dhe mikro. Aktivitetet e zhvillimit të ekosistemit, si dhe të gjitha proceset dhe iniciativat organizative, do të kontribuojnë në promovim.

Kjo strategji parashikon zhvillimin e identitetit të markës, planin e marketingut dhe komunikimit për promovimin ndërkombëtar të ekosistemit sipërmarrës shqiptar, si dhe zhvillimin e markave dhe certifikatave të cilësisë për produktet dhe shërbimet.

Grupet e synuara:

[Shtresat mikro, mezzo dhe makro](#)

Ngritja e programeve model.

Objektivi: Bashkimi i aktiviteteve të programit kryesor të ekosistemit sipërmarrës nën një fokus të vetëm global.

Ai synon të sjellë koordinim dhe përpjekje të strukturuar midis aktorëve të ndryshëm të ekosistemit përmes programeve gjithëpërfshirëse, që do të përfshijnë organizimin e programeve të shkallëzimit ose fillimit, vizitave në rrjete ndërkombëtare, ngjarjeve dhe konferencave ndërkombëtare, të cilat do të nxisin dialogun dhe do të përdorin kanale të strukturuar komunikimi, si platformat dixhitale dhe aplikacionet celulare, për të shpërndarë vlerat e startup-eve tek palët e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Rezultatet:

Programi kryesor i ekosistemit sipërmarrës në Shqipëri bashkon aktivitetet nën një fokus të vetëm global. Ai synon të sjellë koordinim dhe përpjekje të strukturuar midis aktorëve të ndryshëm të ekosistemit përmes programeve gjithëpërfshirëse, si programe për startup-et dhe scale-up-et, vizitave në rrjetet ndërkombëtare, aktiviteteve dhe konferencave ndërkombëtare që do të nxisin dialogun, si dhe përmes kanaleve të tjera të strukturuar të komunikimit si platformat dixhitale dhe aplikacionet celulare. Të gjitha aktivitetet duhet të harmonizohen nën të njëjtin objektiv. Si rrjedhojë, qëllimi i kësaj nisme do të jetë pozicionimi i Shqipërisë në arenën globale dhe rajonale, krijimi i forumeve për diskutime dhe rritje të biznesit, si dhe

inkurajimi i pjesëmarrjes në diskutimet sociale, politike dhe ekonomike që prekin ekosistemet më të avancuara sipërmarrëse. Me këtë objektiv, nisma do të mbështesë markën e Ekosistemit Sipërmarrës të Shqipërisë dhe do të ndihmojë në mbrojtjen dhe forcimin e imazhit të kombit tonë në nivel ndërkombëtar.

Objekti i tij kryesor është të kontribuojë në krijimin e një ekosistemi më të fuqishëm sipërmarrës, të talentuar dhe të aftë për zgjerim, i cili është në gjendje të përmbushë qëllimet e investimeve. Kjo do të ndihmojë në mbylljen e hendeqeve për sa i përket gjinisë, gjeografisë, statusit socio-ekonomik dhe dallimeve të brezave. Ndërhyrja jonë është frymëzuar nga programe të ngjashme të drejtuara nga UK Tech Nation dhe Future Fifty, Scale-up Nation Amsterdam dhe Instituti Lazaridis, Toronto-Waterloo, Kanada.

Programi kryesor do të përfshijë:

- » Mbështetje për mbledhjen dhe analizën e të dhënave të biznesit për startup-et.
- » Programe ndërkombëtare të rrjeteve dhe shkëmbimit të njohurive të krijuara me aktorë ndërkombëtarë të ekosistemeve të hapura të inovacionit dhe në nivel mikro.
- » Konferenca të përvitshme për ndarjen e çmimeve të inovacionit për startup-et.
- » Thirrje vjetore për propozime për NVM-të dhe bizneset fillestare.
- » Krijimin e programeve të mentorimit për bizneset fillestare dhe NVM-të.

Grupet e synuara:

[Shtresat mikro dhe mezzo](#)

Përmirësimi i politikës për sipërmarrjen dhe talentin e grave dhe vajzave.

Objekti: Motivimi dhe angazhimi i talentëve gra në të gjithë ekosistemin sipërmarrës.

Përqendrimi në talentin femëror mund të jetë një diferencues i konsiderueshëm në konkurrencën mbarëbotërore për të tërhequr talentet, veçanërisht ata me aftësi teknike. Shqipëria tashmë po bën hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një reputacioni pozitiv ndërkombëtar dhe krijimit të një mjedisi social dhe profesional të përshtatshëm për zhvillimin e karrierës së grave. Vënia në fokus e talentit femëror është një çështje parimore për kombin tonë. Ka mundësi të konsiderueshme për të rritur përpjekjet tona për të tërhequr më shumë talente gra. Ne propozojmë:

- » Krijimin e një programi për riatdhësimin ose tërheqjen e talentëve për ta kthyer Shqipërinë në një pikë referimi për gra dhe vajza profesioniste.
- » Krijimin e një programi të dedikuar për riatdhësimin e talentëve nga diaspora.
- » Nisjen e një fushate për të motivuar talente të ndryshme që të zhvillojnë karrierën e tyre në Shqipëri, duke parandaluar kështu fenomenin e “ikjes së trurit”.

Nxitja e sipërmarrjes akademike.

Objekti: Rritja e rrjedhës së njohurive midis palëve të interesuara sipërmarrëse dhe akademike me qëllim forcimin e konkurrencës globale si të startup-eve ashtu edhe të akademisë.

Masa synon të stimulojë rritjen e financimeve private për kërkimin dhe zhvillimin, duke krijuar një rrjet të fortë bashkëpunimi.

Në ditët e sotme, ndërkombëtarizimi, lidhja me industrinë dhe komercializimi i njohurive, si dhe sipërmarrja akademike, përfaqësojnë sfidat kryesore për institucionet shqiptare të arsimit të lartë.

Sipërmarrja akademike krijon vlerë ekonomike përmes komercializimit të teknologjive dhe rezultateve të kërkimit të zhvilluara nga individë ose grupe kërkuesish në ambientin akademik. Modeli Triple Helix përfshin universitetet, ekonominë dhe qeverinë si palët kryesore ndërvepruese në modelin kombëtar të inovacionit. Në një mjedis të tillë, ruajtja e lidhjeve ndërmjet aktorëve aktiv dhe produktiv është thelbësore. Kjo strategji ka për qëllim të ofrojë mbështetje gjatë këtij procesi.

Kjo masë synon të:

- » Krijojë një lidhje të përhershme midis aktorëve të Pentagramit, me fokus të veçantë në aspektin akademik. Takimet e rregullta ndërmjet këtyre aktorëve do të ndihmojnë në identifikimin e mundësive dhe sfidave, duke siguruar një këshillim të vazhdueshëm për politikë-bërësit për përmirësimin e mundësive të akademisë në nxitjen e inovacionit dhe komercializimit.
- » Organizojë thirrjet për grante që financojnë sipërmarrjen akademike, të cilat do të ofrojnë një instrument të fuqishëm për të nxitur sipërmarrjen akademike.
- » Krijojë lidhjen e vendit me akademikët dhe investitorët e diasporës.
- » Komercializojë projektet kërkimore të doktoratës.

Masa synon të stimulojë më shumë financime private për kërkimin dhe zhvillimin, duke krijuar një rrjet. Si rezultat, kjo strategji synon të krijojë një kuadër administrativ solid dhe të favorshëm, i cili garanton shpërndarjen afatgjatë të fondeve dhe e bën më të lehtë për bizneset të shfrytëzojnë mjetet e disponueshme. Për më tepër, rritja e aktivizimit të sipërmarrjes brenda universiteteve do të stimulojë një komunikim më të thelluar dhe do të krijojë më shumë mundësi për sipërmarrësit potencialë që të ndjekin ambiciet e tyre.

Grupet e synuara:

[Shtresat mikro dhe mezzo](#)

Talenti, Investimet, Mbështetja e aftësisë për t'u zgjeruar, Masat që lidhen me Qeverinë.

Një grup specifik masash synon zhvillimin, tërheqjen dhe mbajtjen e talenteve, investimet në të gjithë zinxhirin e vlerës së sipërmarrjes, aftësinë për zgjerim, si dhe masat që lidhen me rregulloren dhe politikat. Këto masa janë paraqitur në Tabelën 1 dhe do të zhvillohen më tej.

Tabela 1. Talenti, Investimet, Mbështetja e aftësisë për t'u zgjeruar, Masat që lidhen me Qeverinë.

MASAT			
Talenti	Investimet	Mbështetja e aftësisë për zgjerim përmes infrastrukturës së inovacionit të hapur	Të tjera
Ndërtimi i një mjedisi sipërmarrës dhe njohja e talentëve në sistemin akademik.	Krijimi i një fondi kombëtar për inovacionin dhe sipërmarrjen.	Hartimi dhe zbatimi i Strategjisë së Partneritetit Ndërkombëtar dhe Diasporës.	Zhvillimi i politikave për inovacion.
Nxitja e trajnimeve dhe programeve për zhvillim profesional.	Përcaktimi i një procesi standard për dhënien e granteve.	Krijimi i zyrave të transferimit të njohurive dhe ofrimi i mbështetjes për IP.	Promovimi i përdorimit të të dhënave të hapura.
Krijimi i një mjedisi që nxit të mësuarit dhe përmirësimin e aftësive në mënyrë të vazhdueshme.	Aktivizimi i kapitalit privat nga burime ndërkombëtare, vendase dhe të diasporës.	Krijimi i mjediseve të testimit publik, si Living Labs dhe Smart Communities.	Implementimi i rregullimit inteligjent.
Hartimi i modeleve të bursave për mbështetjen e sipërmarrësve.	Trajnimi i investitorëve individualë.	Identifikimi dhe përfshirja e sektorëve strategjikë si nxitës të sipërmarrjes.	Zhvillimi i politikave për vizat.
Rikualifikimi i talentit të lartë.	Tërheqja e investitorëve të huaj për të mbështetur financimin në fazën fillestare.	Krijimi dhe zbatimi i një programi ndërkombëtar për rritjen/zgjerimin.	
Tërheqja e talentëve nga diaspora përmes stimuljeve të përshtatshëm.	Nxitja e transferimit të njohurive.	Përfshirja e burimeve ndërkombëtare dhe të diasporës në gjenerimin e rrjeteve të biznesit.	
Përkrahja e sipërmarrësve të talentuar përmes promovimit në platforma dixhitale.	Mbështetje akademike për kalimin nga laboratorit në treg.	Angazhimi dhe stimulimi i rritjes së korporatave dhe bashkëpunimit me shumë shtresa.	
Sigurimi i njohjes së talentëve përmes organizimit të konferencave dhe mundësive të rrjetëzimit.	Ofrimi i aksioneve për punonjësit.	Angazhimi i instrumenteve financiare ndërkombëtare.	
Tërheqja e nomadëve dixhitalë.	Sigurimi i financimit të borxhit.	Zhvillimi i grupeve dhe i supergrupeve.	
Sigurimi i mundësive për mentorim dhe sponsorizim të talentëve.	Ofrimi i shënimeve të konvertueshme.	Krijimi i stimuljeve për projekte startup nga diaspora dhe institucionet akademike.	
Lehtësimi i ndërmjetësimit.	Ngritja e instrumenteve të Kapitalit të Korporatave për Sipërmarrjen (CVC).		
Krijimi i programeve të dedikuara për gratë sipërmarrëse.	Prokurimi publik i produkteve dhe shërbimeve inovative.		
Lidhja e startup-eve dhe sipërmarrësve individualë me iniciativat e BE-së.			
Monitorimi i hendekut gjinor.			
Monitorimi i hendekut sipas grupmoshave.			
Monitorimi i hendekut rajonal.			

QEVERISJA E STRATEGJISË

Qeverisja e Strategjisë synon të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të ekosistemit dhe zbatimin efikas të masave të parashikuara nga kjo strategji.

Ministri përgjegjës për sipërmarrjen: Ministri harton dhe drejton politikat për zhvillimin e sipërmarrjes dhe ekosistemit të startup-ve dhe lehtësuesve. Ministri bashkërendon politikat qeverisëse dhe miraton thirrjet për financim, skemat e granteve, si dhe përcakton prioritetet brenda kuadrit të programit të qeverisë. Ministri luan një rol kyç në organizimin e ndihmës së huaj për të realizuar qëllimet e politikave dhe objektivave.

Agjencia Shtetërore Startup Albania: Agjencia Shtetërore Startup Albania do të bëhet dora e dukshme që shtyn levat e inovacionit, shkëmbimit të njohurive, industrializimit dhe zhvillimit të politikave. Ajo do të mbikëqyrë zbatimin e strategjisë në të gjitha përpjekjet e qeverisë për inovacion dhe do të marrë rolin e koordinatorit për angazhimin ndërmjet institucioneve publike. Ajo do të koordinojë aktivitetet ndërmjet të gjitha palëve të interesuara në ekosistem dhe në strategjinë e sipërmarrjes, duke krijuar një mjedis ku burimet bashkohen dhe mbështesin strategjinë kombëtare. Po ashtu, Agjencia do të sigurojë që propozimet për masat e përfshira në këtë dokument të analizohen dhe vlerësohen nga ministritë përkatëse.

Ministri përgjegjës për ekonominë dhe inovacionin: Ministri është përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e politikave të qeverisë në sferën makro dhe mikroekonomike të tregtisë dhe sipërmarrjes, duke ndihmuar në krijimin e një modeli ekonomik që synon garantimin e një rritjeje të qëndrueshme dhe të lartë ekonomike për Shqipërinë. Ministri mirëadministron burimet, harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësor të ekonomisë, konvergimet ekonomike dhe sociale të rajoneve të vëndit, përmirësimit të klimës dhe të shërbimeve për biznesin dhe qytetarin. Synon dhe mundëson stimulimin e aktiviteteve inovative të cilat do të rrisin pro-

duktivitetin ekonomik dhe institucional, përmes zhvillimit të teknologjisë dhe bashkëpunimit efikas. Gjithashtu bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 466, datë 30.7.2021 “*Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021– 2027, dhe të planit të saj të veprimit*”, konkretisht për masën “Përputhja midis NVM-ve dhe startup-eve”, e cila ka për qëllim promovimin e lidhjeve midis startupeve dhe bizneseve të themeluara, si dhe forcimin e bashkëpunimit efektiv mes komunitetit të startup-eve dhe bizneseve (NVM-ve), AIDA dhe Agjencia Startup Albania do të duhet të bashkëpunojnë ngushtë.

Këshilli i Startup-ve: Këshilli i Startup-eve kryesohet nga Ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë të tjerë nga institucione të lidhura me shërbimet e ofruara për biznesin, startup-et dhe ekosistemin, sektori privat dhe academia.

Ministri përgjegjës për financat: Ministri siguron që masat e parashikuara në këtë strategji të përputhen me kriteret e politikës fiskale të qeverisë.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimin të Ndhmës (SASPAC): Siguron koordinimin e ndihmës së huaj për programet dhe projektet zhvillimore, si dhe ofrimin e mbështetjes metodologjike në hartimin e strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale, me qëllim harmonizimin e tyre me SKZHI-në, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre, koordinimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar, ofrimin e mbështetjes për institucionet e administratës shtetërore për rritjen e kapaciteteve në fushën e programeve dhe projekteve zhvillimore.

PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit parashikon një sërë aktiviteteve që synojnë të vendosin qeverisjen dhe menaxhimin e ekosistemit sipërmarrës. Aktivitetet e përshkruara do të ofrojnë stimuj shtesë për sipërmarrjen akademike dhe angazhimin e diasporës. Në këtë mënyrë, këto dy grupe do të motivohen veçanërisht për të kontribuar në zhvillimin e ekosistemit.

Ne propozojmë një plan të strukturuar në tre faza: faza e parë (afatshkurtër: 2024-2025), e dytë (afatmesme: 2026-2027), dhe e tretë (afatgjatë: 2028-2030).

Strategjia parashikon tre faza të ndryshme të zhvillimit të ekosistemit sipërmarrës:

- » **2024-25 është faza e fillimit.** Në këtë fazë do të përshkruhet infrastruktura për qeverisjen dhe menaxhimin e ekosistemit. Do të hidhen themelet për menaxhimin e Agjencisë Shtetërore Startup Albania, financimin dhe investimin, transferimin e njohurive dhe certifikimin institucional për inkubatorët. Për më tepër, do të zhvillohet platforma dixhitale dhe do të krijohen infrastruktura të inovacionit të hapur dhe Qendrat Rajonale të Transformimit (QRT) për të lejuar menaxhimin e ekosistemit në të ardhmen. Në këtë fazë do të bëhet përgatitja për ngritjen e Parkut Teknologjik. Zhvillimi i markës, certifikimi i sipërmarrjes, ofrimi i shërbimeve të zhvillimit të biznesit dhe organizimi i konferencës ndërkombëtare të startup-ve do të mundësojë ndërkombëtarizimin e ekosistemit. Faza e parë është kyçe për vendosjen e bazave të ekosistemit, duke mundësuar kështu zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe shërbimeve në fazën e dytë.
- » **2026-27 është faza e konsolidimit.** Infrastruktura e krijuar në fazën e parë përmes Startup Albania dhe QRT, do të lejojë zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës së inovacionit të hapur³⁴, duke përfshirë planifikimin për Parkun Teknologjik, komunitetet inteligjente, laboratorët e testeve dhe forma të tjera të elementeve infrastrukturore të inovacionit. Këta

elementë të rinj do të integrojnë aktorë të ekosistemit në nivele të tjera të Pentagramit, duke prezantuar përdoruesit dhe publikun me zhvillimin e produkteve të reja dhe duke angazhuar më intensivisht sipërmarrësit në shtimin e vlerës së produkteve dhe shërbimeve të tyre. Kjo do të tërheqë më tej interesin e investitorëve vendas dhe të huaj në të gjitha nivelet, duke përfshirë aktorë të tillë si investitorët individualë të biznesit dhe ndërmarrjet që kërkojnë një klimë optimale investimi. Nëpërmjet hartëzimit dhe diagnostikimit të vazhdueshëm të ekosistemit, do të mundësohet përmirësimi i vazhdueshëm i klimës dhe kulturës së sipërmarrjes, ofrimi i shërbimeve të optimizuara si hackathon-ët, ideathon-ët dhe creathon-ët, rritja e shtrirjes së konferencave ndërkombëtare, fillimi i dialogut midis partnerëve të ekosistemit, ndërtimi i mëtejshëm i platformave dixhitale dhe të tjera.

- » **2028-30 është faza operacionale.** Pas konsolidimit të strukturës së qeverisjes së ekosistemit dhe krijimit të kuadrit për zhvillimin e ekosistemit të startup-eve, përmirësimi i infrastrukturës së inovacionit të hapur do të rrisë ritmin e zhvillimit të startup-eve dhe do të mundësojë akses më të gjerë në tregjet globale për produktet dhe shërbimet e tyre. Në këtë fazë, krijimi i Qendrave Rajonale të Transformimit, Parkut Teknologjik, laboratorëve dhe komuniteteve inteligjente do të mundësojë që ekosistemi shqiptar të konkurrojë me cilësi në mjediset më të avancuara globale të inovacionit, duke mbajtur ende një avantazh në çmim për zhvillimin e produktit të ri për investitorët.

Tabela 2. Veprime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për zbatimin e masave prioritare.

Objektivat	Indikatorët		
Objektivat (Masat prioritare)	Veprimet afatshkurtër 2024-25	Veprimet afatmesme 2026-27	Veprimet afatgjata 2028-30
Krijimi i kapaciteteve të Agjencisë Shtetërore Startup Albania. Ngritja e qeverisjes së ekosistemit dhe bashkërendimi dhe harmonizimi i angazhimit të palëve të interesuara. Grupet e synuara: niveli makro Rezultatet: - Strategjia e zhvilluar. - Shërbimet Startup Albania të zhvilluara. - Qeverisja mbi ekosistemin e ngritur.	Zhvillimi i Strategjisë së Sipërmarrjes Inovative. Treguesit: - Strategjia e pranuar.	Asistencë teknike në zbatimin e modelit të qeverisjes të parashikuar në strategji. Bashkëpunim i ngushtë me Ministrinë dhe aktorë të tjerë makro për të zhvilluar modelin funksional të qeverisjes bazuar në përvojën e fituar nëpërmjet krijimit të Qendrës Rajonale të Transformimit (QRT). Treguesit: - Përshkrimi i detajuar dhe përgatitja institucionale për krijimin e modelit të qeverisjes. - Krijimi i modelit të qeverisjes së ekosistemit.	Monitorimi dhe propozimi i përmirësimeve për modelin dhe strategjinë e qeverisjes. Treguesit: - Raporti i zbatimit të qeverisjes. - Propozim për përmirësime në modelin e qeverisjes.
	Ndërtimi i shërbimeve për Agjencinë Shtetërore Startup Albania. Fokusimi në zhvillimin e sipërmarrjeve akademike, përfshirjen e diasporës dhe fuqizimin e grave në sipërmarrje. Ndërtimi i programeve për mbështetjen teknike dhe financiare të startupeve dhe inkubatorëve në sektorët e gjelbër dhe dixhital. Treguesit: - Analiza e nevojave për shërbime të ofruara. - 5 shërbime të zhvilluara.	Operimi i Agjencisë Shtetërore Startup Albania. Analiza e shërbimeve dhe përmirësimet. Financimi i startup-eve dhe inkubatorëve, të cilët fokusohen në sektorët e gjelbër dhe dixhital. Treguesit: - Analiza vjetore e shërbimeve të ofruara nga Agjencia Shtetërore Startup Albania. - Propozim për përmirësimin e shërbimeve. - Propozim për 1 shërbim të ri në vit. - Financimi i 15 startup-eve dhe 5 inkubatorëve të fokusuar në sektorin e gjelbër dhe dixhital.	
Hartëzimi dhe diagnostikimi i vazhdueshëm i ekosistemit dhe programeve të rritjes. Grupet e synuara : niveli mikro, i mesëm, makro Rezultatet: - Ekosistemi i hartëzuar. - Sigurimi i diagnostikimit të nevojave, maturimit dhe treguesve kritikë të ekosistemit. – Vendosja e procesit të vazhdueshëm të hartëzimit dhe diagnostikimit. – Vendosja e mekanizmit raportues mbi statusin e ekosistemit.	Hartëzimi i ekosistemit. Treguesit: - Hartëzimi i ekosistemit shqiptar për të gjithë aktorët e ekosistemit dhe krijimi i bazës së të dhënave të mëdha. -Ofrimi i hartës dixhitale me vendndodhje për të gjithë aktorët e hartëzuar.	Implementimi i procesit të hartës dhe diagnostikimit të vazhdueshëm. Prodhimi i raporteve vjetore të statusit të ekosistemit. Treguesit: - Propozimi i hartës së vazhdueshme dhe procesit diagnostikues. - Ekzekutimi i hartës dhe procesit diagnostikues çdo vit. - Raporte sektoriale dhe të konsoliduara. - Përmbledhje ekzekutive e komunikuar në të gjithë ekosistemin.	
	Diagnostikimi i ekosistemit. Pjesë e ndërtimit të strategjisë. Raport mbi ekosistemin e Shqipërisë. Treguesit: - Zhvillimi i pyetësorit. - Intervistimi i të paktën 150 aktorëve nga niveli mikro, 30 nga niveli i mesëm dhe 20 nga niveli makro. - Diagnostikimi sektorial dhe raporti i konsoliduar.		

Mbështetja dhe zhvillimi i infrastrukturës së inovacionit të hapur, fizike dhe virtuale. Grupet e synuara: niveli mikro dhe i mesëm Rezultatet: - Krijimi i infrastrukturës së inovacionit të hapur që përbëhet nga Qendrat Rajonale të Transformimit, inkubatorët, akseleratorët dhe aktorët e inovacionit të hapur, siç janë komunitetet inteligjente, laboratorët e gjallë dhe struktura të ngjashme. - Zhvillimi i platformës dixhitale plotësisht funksionale dhe i aplikacionit celular, që shërben si kanali kritik i komunikimit të ekosistemit, si dhe zhvillimi i platformës për ofrimin e shërbimeve. - Zhvillimi i një rrjeti inkubatorësh profesionalë. - Zhvillimi i rrjetit të inovacionit të hapur me infrastrukturë të ngjashme me atë ndërkombëtare për inovacionin e hapur.	Certifikimi i inkubatorëve nëpërmjet lejeve. Treguesit: - Certifikimi i të paktën 10 inkubatorëve, 5 të fokusuar në sektorin e gjelbër dhe dixhital.	Përgatitja dhe ekzekutimi i granteve për inkubatorët. Fokusimi në inkubatorët me bazë universitare, komercializimi i projekteve kërkimore, dhe fokus i dedikuar në zgjidhjet e gjelbëra dhe dixhitale. Treguesi: - 1 thirrje në vit.		
	Përgatitja e dokumentacionit për ngritjen e infrastrukturës së harmonizuar në shkallë të plotë, fizike dhe virtuale. Përgatitja e një modeli biznesi për Qendrat Rajonale të Transformimit dhe Parkun Teknologjik. Treguesit: - Regjistrimi i startup-eve dhe mbështetja për ndërtimin e planit të biznesit, si dhe dokumentacioni përkatës për zhvillimin e QRT-së i përgatitur dhe i miratuar nga organet kompetente të pushtetit vendor dhe qendror.	Përgatitja e një modeli dhe plani biznesi për infrastrukturën e inovacionit të hapur: inkubatorët e përgjithshëm dhe të fokusuar vertikalisht, Qendrat Rajonale të Transformimit, Qendrat e Inovacionit Dixhital, komunitetet inteligjente dhe laboratorët e gjallë që kontribuojnë në inovacionin e hapur. Ofrimi i shërbimeve IP për fillestarët. Treguesit: - Plani i biznesit dhe dokumentacioni përkatës për zhvillimin e rrjetit të zgjeruar të inovacionit të hapur i përgatitur dhe i pranuar nga organet kompetente të pushtetit vendor dhe qendror.	Investim në rritjen dhe popullimin e Parkut Teknologjik, komuniteteve inteligjente dhe projekteve të laboratorëve të gjallë, së bashku me pushtetin vendor. Treguesit: - 50 kompani startup të fokusuara në kërkim dhe zhvillim, si dhe në infrastructure, fillojnë operimin në Parkun Teknologjik brenda vitit 2030.	
	Krijimi i programeve të para-inkubacionit, një për veriun dhe një për pjesën jugore të Shqipërisë. Treguesit: - Programet e para-inkubacionit të hartëzuara. - Programet e para-inkubacionit të ekzekutuara.	Fillimi i fazës operacionale duke ofruar shërbime fizike për startup-et. Organizimi i hackathon-ëve së bashku me universitetet për zhvillimin e zgjidhjeve apo produkteve dixhitale dhe inovative. Transferimi i programeve të para-inkubacionit në QRT. Treguesit: - Krijimi i QRT-së së dytë. - Krijimi dhe fillimi i programeve të para-inkubacionit dhe inkubacionit. - Organizimi i 5 hackathon-ëve.		Zhvillimi i lidhjeve me inkubatorët ndërkombëtarë të BE-së dhe zgjerimi i shërbimeve. Rritja e portofolit të shërbimeve për para-inkubacionin dhe inkubacionin. Treguesit: - Hartëzimi dhe zbatimi i 5 shërbimeve të reja për startup-et.
	Krijimi i një Qendre Rajonale të Transformimit (QRT) Treguesi: - Krijohet një QRT.			Krijimi i rrjetit kombëtar të inkubatorëve. Monitorimi dhe përmirësimi i rrjetit. Treguesit: - Baza e të dhënave e partnerëve ndërkombëtarë dhe plani i komunikimit në rrjet i hartuar dhe i ekzekutuar.
	Zhvillimi i platformës së IT-së dhe aplikacionit celular. Treguesit: - Specifikimi i Kërkesave të Softuerit (SRS), Analiza e Kërkesave të Përdoruesit (URA), platforma e IT-së dhe aplikacioni celular të zhvilluar. -Platforma dixhitale dhe aplikacioni celular plotësisht funksionalë.	Ofrimi i shërbimeve dixhitale për startup-et përmes platformës së IT-së dhe aktiviteteve të tjera. Ofrimi i asistencës teknike për inovacion dhe dixhitalizim (shërbimet IP, rrjetëzimi, ndërkombëtarizimi, mësimi elektronik, depozitimi i dokumenteve etj.). Treguesi: - 5 shërbime dixhitale të ofruara për 100 NVM.		Vazhdimi i funksionaliteteve të mëparshme të platformës dixhitale dhe përmirësimi i tyre. Treguesit: -Përmirësimi i të gjitha funksioneve të platformës dixhitale. -5 funksionalitete të reja për platformën dixhitale. -100 NVM të reja çdo vit të përfshira në shërbimet e platformës dixhitale.
	Ngritja e reputacionit ndërkombëtar të ekosistemit. Grupet e synuara : niveli mikro, i mesëm, makro Rezultatet: - Krijimi i markës së sipërmarrjes në Shqipëri. - Krijimi i markës dhe certifikatës së sipërmarrjes në Shqipëri. - Ekzekutimi i planit të marketingut të markës dhe certifikatës.	Përforcimi i identitetit të ekosistemit sipërmarrës shqiptar përmes krijimit të markës dhe certifikatës kombëtare për startup-et. Treguesit: -Identiteti i markës së ekosistemit të sipërmarrjes në Shqipëri është zhvilluar. -Strategjia e komunikimit dhe marketingut të ekosistemit të sipërmarrjes në Shqipëri është zhvilluar.		Zhvillimi dhe ekzekutimi i planit të marketingut dhe komunikimit për promovimin ndërkombëtar të startup-eve, markave dhe certifikatave shqiptare. Treguesit: - Zbatimi i identitetit të markës së ekosistemit të sipërmarrjes në Shqipëri. - Zbatimi i strategjisë së komunikimit dhe marketingut të ekosistemit të sipërmarrjes në Shqipëri.

Ndërtimi i instrumenteve të financimit. Grupet e synuara: investitorët e biznesit, VC, niveli mikro, i mesëm, makro Rezultatet: - Mbështetja financiare e ekosistemit nga bankat e zhvillimit dhe fushata ndërgjegjësuere e krijuar. - Krijohet fondi i inovacionit për dhënien e zgjidhjeve më të mira për startup-et. - Programi i trajnimit të investitorëve të biznesit i themeluar.	Negocimi i produkteve financiare të startup-eve me bankat e zhvillimit (BB, FMN, BERZH, EIB etj.). Treguesit: - Agjencia Shtetërore Startup Albania nënshkruan dy MM me bankat e zhvillimit.	Fushata sensibilizuese për financimin e bankave zhvillimore (BB, FMN, BERZH, EIB) dhe financimin e projekteve të startup-eve. Treguesit: - Minimumi 10 projekte të financuara për periudhën afatmesme. - Fushata ndërgjegjësuere e planifikuar dhe e realizuar.	Fushata sensibilizuese për financimin e bankave zhvillimore (BB, FMN, BERZH, EIB) dhe financimin e projekteve të startup-eve. Treguesit: - Minimumi 10 projekte të financuara për periudhën afatmesme. - Fushata ndërgjegjësuere e planifikuar dhe e realizuar.
	Krijimi i fondit të inovacionit për gjetjen e zgjidhjeve inovative më të mira të startup-eve. Është caktuar buxheti për fondet e dhëna. Është vendosur thirrja për propozime dhe grante për startup-et. Treguesit: - Fondi i krijuar në përputhje me ligjin dhe rregulloret shqiptare. - Llogaria e fondit është hapur dhe buxheti është transferuar. - Fondet u jepen startup-eve fituese në konferencën përkatëse. - Thirrjet fillestare për propozime për NVM-të dhe startup-et janë publikuar dhe grantet janë dhënë.	Fondi i inovacionit është funksional. Është caktuar buxheti për fondet e dhëna. Është vendosur thirrja për propozime dhe grante për startup-et. Treguesit: - Buxheti është transferuar në llogarinë e fondit. - Fondet u jepen startup-eve fituese në konferencën përkatëse. - Thirrjet për propozime për NVM-të dhe startup-et janë publikuar dhe grantet janë dhënë.	Fondi i inovacionit është funksional. Është caktuar buxheti për fondet e dhëna. Është vendosur thirrja për propozime dhe grante për startup-et. Treguesit: - Buxheti është transferuar në llogarinë e fondit. - Fondet u jepen startup-eve fituese në konferencën përkatëse. - Thirrjet për propozime për NVM-të dhe startup-et janë publikuar dhe grantet janë dhënë.
	Krijohet një program trajnimi për investitorët e biznesit. Treguesit: - Trajnimi i 10 investitorëve të biznesit. - Ftohen investitorët ndërkombëtarë të biznesit për të transferuar njohuritë e tyre. - Ndiqen programet e trajnimit të investitorëve të biznesit.	Ndjekja e investitorëve të biznesit dhe aktiviteteve të tyre. Trajnimi i gjeneratës së ardhshme të investitorëve të biznesit. Treguesit: - Trajnimi i 15 investitorëve të biznesit. - Ftohen investitorët ndërkombëtarë të biznesit për të transferuar njohuritë e tyre. - Ndiqen programet e trajnimit të investitorëve të biznesit.	Krijimi i programit afatgjatë për zhvillimin e rrjetit të investitorëve të biznesit. Vazhdimi i aktiviteteve të trajnimit për 10 engjëj biznesi çdo vit. Treguesit: - Trajnimi i 15 investitorëve të biznesit. - Ftohen investitorët ndërkombëtarë të biznesit për të transferuar njohuritë e tyre. - Ndiqen programet e trajnimit të investitorëve të biznesit. - Krijohet programi afatgjatë për trajnimin e investitorëve të biznesit bazuar në përvojën e kaluar.
Tërheqja e fondeve ndërkombëtare dhe të investitorëve të diasporës. Grupi i synuar : rrjeti financiar vendas dhe ndërkombëtar, niveli mikro dhe i mesëm Rezultatet: - Fushata e marketingut për ekosistemin e sipërmarrjes së inovacionit të hapur e planifikuar dhe e ekzekutuar.	Ngritja e marrëdhënieve të forta ndërkombëtare me diasporën, hartëzimi i rrjeteve të startup-eve dhe VC-ve, promovimi i infrastrukturës së inovacionit të hapur dhe ekosistemit sipërmarrës jashtë vendit. Fushata e marketingut e planifikuar. Treguesit: - Plani i promovimit të marketingut dhe komunikimit. - Baza e të dhënave ndërkombëtare të palëve të interesuara. - Përhapja përmes infrastrukturës dixhitale.	Ndërtimi i marrëdhënieve të forta ndërkombëtare me diasporën, hartëzimi i rrjeteve të startup-eve dhe VC-ve, promovimi i infrastrukturës së inovacionit të hapur dhe ekosistemit sipërmarrës jashtë vendit. Planifikimi dhe zbatimi i fushatës së marketingut. Treguesit: - Ekzekutimi i planit të marketingut. - Ekzekutimi i planit të komunikimit.	

Programet kryesore. Grupet e synuara : niveli mikro dhe makro Rezultatet: - Mbështetja e startup-eve të krijuara përmes inteligjencës së biznesit. - Rrjetet ndërkombëtare dhe programet e shkëmbimit të njohurive të krijuara me aktorë ndërkombëtarë të ekosistemeve të hapura të inovacionit nga nivelet e mesme dhe mikro. - Konferenca e fondeve për startup-et inovative e organizuar çdo vit. - Thirrja për propozime për NVM-të dhe startup-et e ekzekutuar çdo vit. - Programe mentorimi për startup-et dhe NVM-të të ndërtuara.	Krijimi i procesit dhe ofrimi për startup-et i një analize tregu dhe shërbimeve profesionale dixhitale të inteligjencës së biznesit përmes Mintel, Euromonitor ose të ngjashme. Treguesit: - Krijimi i editorialit për gjenerimin e raportit të inteligjencës së biznesit. - Licencat për platformat e inteligjencës së biznesit të prokuruara. - Raporti vjetor i gjeneruar. - Buletini mujor i krijuar dhe publikuar në platformën dixhitale.	Ofrimi i analizave të rregullta të tregut, trendeve dhe perspektivës së tregjeve të eksportit për startup-et. Gjenerimi i tre raporteve të analizës së tregut dhe shpërndaja e tyre ndërmjet aktorëve të ekosistemit fillestar. Mbledhja e komenteve dhe përmirësimi i raportimit. Treguesit: - Krijimi i editorialit për gjenerimin e raportit të inteligjencës së biznesit. - Licencat për platformat e inteligjencës së biznesit të prokuruara. - Raporti vjetor i gjeneruar. - Buletini mujor i krijuar dhe publikuar në platformën dixhitale.	Vazhdimi me mekanizmat e mëparshme dhe zhvillimi i mekanizmave të reagimit për mbledhjen e përvojave dhe historive të suksesit nga aktorët e ekosistemit fillestar. Treguesit: - Krijimi i editorialit për gjenerimin e raportit të inteligjencës së biznesit. - Licencat për platformat e inteligjencës së biznesit të prokuruara. - Raporti vjetor i gjeneruar. - Buletini mujor i krijuar dhe publikuar në platformën dixhitale.	
	Organizimi i vizitave të rrjeteve ndërkombëtare në parqe dhe grupime teknologjike për aktorët e nivelit të mesëm (Qendra Rajonale e Transformimit) dhe të nivelit mikro (startup-et). Treguesit: - Ofrohet studimi krahasues i ekosistemeve të sipërmarrjes. - Janë realizuar vizita në rrjete ndërkombëtare.	Organizimi i programit të shkëmbimit të njohurive me parqet dhe grupimet ndërkombëtare të teknologjisë. Krijimi i një baze të dhënash dhe rrjeti organizatash kombëtare dhe ndërkombëtare fillestare. Treguesit: - Ofrohet studimi krahasues i ekosistemeve të sipërmarrjes. - Janë realizuar vizita në rrjete ndërkombëtare.	Organizimi i programeve të shkëmbimit të njohurive me parqe teknologjike ndërkombëtare, grupe, fonde inovacioni, shoqata investitorësh të biznesit, shoqata fillestare dhe struktura të ngjashme. Vazhdimi me mekanizmat e mëparshme, përcaktimi i metrikave dhe ndjekja e arritjes së objektivave. Treguesit: - Ofrohet vazhdimi i studimit të krahasimit të ekosistemeve të sipërmarrjes. - Janë realizuar vizita në rrjete ndërkombëtare.	
	Organizimi i aktiviteteve për promovimin e fondeve të inovacionit dhe konferencave për startup-et. Fonde për startup-et më të mira. Tërheqja e organizatave rajonale të inovacionit, investitorëve të biznesit, shoqatave startup, përfaqësuesve të diasporës dhe aktorëve të ngjashëm. Treguesit: - Organizohet konferenca vjetore e dhënies së fondeve për inovacionin. - Baza e të dhënave e pjesëmarrësve është e lidhur me platformën dixhitale.	Organizimi i një aktiviteti vjetor të ndarjes së çmimeve për startup-in më të mirë. Promovimi i aktivitetit ndërkombëtarisht. Thirrja e organizatave ndërkombëtare të inovacionit, investitorëve të biznesit, shoqatave fillestare dhe aktorëve të ngjashëm. Treguesit: - Organizohet konferenca vjetore e dhënies së fondeve për inovacionin. - Baza e të dhënave e pjesëmarrësve është e lidhur me platformën dixhitale.	Vazhdimi i lidhjeve ekzistuese dhe krijimi i lidhjeve të reja (MM, marrëveshje, etj.) me aktivitetet ndërkombëtare, si dhe bashkëorganizimi i një aktiviteti ndërkombëtar në kuadër të konferencës ndërkombëtare të startup-eve. Treguesit: - Organizohet konferenca vjetore e dhënies së fondeve për inovacionin. - Baza e të dhënave e pjesëmarrësve është e lidhur me platformën dixhitale.	
	Publikimi i thirrjeve për propozime për NVM dhe grante fillestare. Treguesit: - 1 thirrje në vit gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë.			
	Zhvillimi i programeve të mentorimit, krijimi i rrjetit të mentorëve. Treguesit: - Programi i mentorimit është zhvilluar. - Ofrohet analiza e nevojave për mentorimin.	Ofrimi i 800 orëve mentorim për startup-et. Treguesit: - Ofrohen 800 orë mentorimi për startup-et. - Analiza e programit të mentorimit dhe përmirësimet e sugjeruara për sistemin e ardhshëm të mentorimit.	Krijimi i një programi mentorimi afatgjatë për të mbështetur nevojat, sipas rezultateve të hartëzimit dhe diagnostikimit. Treguesit: - Ofrohen 800 orë mentorimi për startup-et. - Analiza e programit të mentorimit dhe përmirësimet e sugjeruara për ciklin e ardhshëm të mentorimit. - Propozohet programi afatgjatë i mentorimit.	

Nxitja e sipërmarrjes akademike. Grupi i synuar : niveli mikro, i mesëm, makro Rezultatet: - Komunikimi dhe koordinimi Tripple Helix i vendosur. - Ofrohen grante për sipërmarrjen akademike.	Organizimi i takimeve të aktorëve të Tripple Helix në nivel lokal dhe kombëtar për të diskutuar nevojat aktuale të bashkëpunimit. Përfshirja e universiteteve lokale. Treguesit: - 4 takime në nivel lokal me 30 pjesëmarrës, përfaqësues të ekosistemit. - 1 takim në nivel kombëtar me 30 pjesëmarrës, përfaqësues të ekosistemit.	Organizimi dhe vendosja e sesioneve të rregullta Tripple Helix çdo tre muaj në nivel lokal në të paktën dy rajone shqiptare (6 sesione në 2 rajone). Treguesit: - 4 takime në nivel lokal me 30 pjesëmarrës, përfaqësues të ekosistemit. - 1 takim në nivel kombëtar me 30 pjesëmarrës, përfaqësues të ekosistemit.	Vazhdimi me mekanizmat e mëparshme dhe ndjekja e arritjes së objektivave. Treguesit: - 4 takime në nivel lokal me 30 pjesëmarrës, përfaqësues të ekosistemit. - 1 takim në nivel kombëtar me 30 pjesëmarrës, përfaqësues të ekosistemit.
	Grante për sipërmarrjet akademike dhe startup-et e themeluara nga akademikët. Fokusimi në komercializimin e kërkimeve të lidhura me doktoraturën. Treguesit: - 1 thirrje në vit gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë.		
Përmirësimi i politikës për sipërmarrjen dhe talentin e grave. Grupi i synuar : niveli mikro, sipërmarrëset gra. Rezultatet: - Vendosen stimujt për sipërmarrjen femërore.	Hartimi i thirrjeve për propozime që synojnë sipërmarrjen femërore. Treguesit: - 1 thirrje në vit gjatë periudhës së zbatimit të strategjisë.		

BUXHETI I NIVELIT TË LARTË DHE MEKANIZMAT FINANCIARË

Buxheti do të përdorë të gjitha instrumentet financiare që janë tashmë të vendosura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Modeli i financimit do të bazohet në maturimin e ekosistemit. Në tre vitet e para, mbështetja e qeverisë do të jetë thelbësore dhe do të luajë një rol më të madh. Në fazën pasuese, 2027-2030, do të jetë në dispozicion një kombinim i fondeve publike dhe private. Gjithashtu, synimi është të ndërtohet në mënyrë inovative një fond i mjaftueshëm për realizimin e kësaj strategjie ambicioze dhe mbështetjen e një ekosistemi startup në rritje.

Tabela 3. Buxheti i parashikuar për tre faza të zhvillimit të ekosistemit në LEK.

Indikatorët e Buxhetit	Parashikimi 2025 - 2030	Financimi nga Buxheti i Qeverisë 2025 - 2030	Financimi i Huaj	Hendeku Financiar 2025 - 2030
Ngritja e qeverisjes së ekosistemit dhe bashkërendimi dhe harmonizimi i angazhimit të aktorëve.	15 000 000,00	15 000 000,00	-	-
Hartëzimi dhe diagnostikimi i vazhdueshëm i ekosistemit dhe programeve të rritjes.	90 950 000,00	90 950 000,00	-	-
Ndërtimi i infrastrukturës së inovacionit, fizike dhe virtuale.	500 000 000,00	250 000 000,00	-	250 000 000,00
Ndërtimi i reputacionit ndërkombëtar të ekosistemit.	69 500 000,00	29 500 000,00	20 000 000,00	20 000 000,00
Ndërtimi i instrumenteve të financimit.	90 000 000,00	65 000 000,00	20 000 000,00	5 000 000,00
Tërheqja e fondeve ndërkombëtare dhe të investitorëve nga diaspora.	89 000 000,00	45 000 000,00	15 000 000,00	29 000 000,00
Programe kryesore të rritjes për sektorët e gjelbër dhe dixhital.	600 000 000,00	100 000 000,00	500 000 000,00	-
Nxitiqja e sipërmarrjes nga academia.	75 000 000,00	75 000 000,00	-	-
Përmirësimi i politikës për sipërmarrjen dhe talentin e grave.	45 000 000,00	45 000 000,00	-	-
SHUMA TOTALE	1 574 450 000,00	715 450 000,00	555 000 000,00	304 000 000,00

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE

Strategjia Shqiptare e Sipërmarrjes synon të formësojë ekosistemin sipërmarrës të inovacionit të hapur në Shqipëri. Është investim shqiptar për të ardhmen e ekonomisë së vendit, duke ndjekur rrugën e Specializimit Inteligjent, qasjen më të fundit për qeverisjen e ekosistemit dhe menaxhimin e njohurive. Ajo orienton Shqipërinë në ristrukturimin e ekonomisë së saj drejt një ekonomie të bazuar në njohuri, konkurruese dhe të gjallë, me fokus në eksport.

Strategjia fokusohet në krijimin e një ekosistemi kombëtar, ku një grup kompleks mekanizmesh të përshkruar do të mundësojë ndërtimin e një rrjeti aktorësh shumështrësor, të cilët do të jenë sinergjikë në vlerat, objektivat dhe qëllimet e tyre. Që një rrjet i tillë heterogjen të funksionojë, nevojitet angazhimi i të gjithë aktorëve të ekosistemit.

REFERENCAT

- 1 Acs, Z. J., Estrin, S., Mickiewicz, T., & Szerb, L. (2014). The continued search for the Solow residual: The role of national entrepreneurial ecosystem.
- 2 Chesbrough, H. (2004). Managing open innovation. *Research-technology management*, 47(1), 23-26.
- 3 Džanić, E. (2018). Organisational Culture and Open Innovation: The Case of a Large Food Processing Company (Doctoral dissertation, E. Džanić).
- 4 Radziwon, A., & Bogers, M. (2019). Open innovation in SMEs: Exploring inter-organizational relationships in an ecosystem. *Technological Forecasting and Social Change*, 146, 573-587.
- 5 Leviäkangas, P., & Öörni, R. (2020). From business models to value networks and business ecosystems – what does it mean for the economics and governance of the transport system? *Utilities Policy*, 64, 101046.
- 6 Garcia, R., Wigger, K., & Hermann, R. R. (2019). Challenges of creating and capturing value in open eco-innovation: Evidence from the maritime industry in Denmark. *Journal of Cleaner Production*, 220, 642-654.
- 7 Onetti, A. (2014). Scaleups: When does a startup turn into a scaleup? *Startup Europe Partnership*.
- 8 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji Nr. 25/2022 Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve., (2023).
- 9 Eurostat. (n.d.). High-growth enterprises - statistics. [Ec.europa.eu](https://ec.europa.eu/eurostat).
- 10 Leydesdorff, L., & Etzkowitz, H. (1998). The triple helix as a model for innovation studies. *Science and public policy*, 25(3), 195-203.
- 11 OECD. (2010). High-growth enterprises: What governments can do to make a difference. *OECD Studies on SMEs and Entrepreneurship*. OECD Publishing.
- 12 European Commission. (2024). Estonia 2024 Digital Decade Country Report. [Ec.europa.eu](https://ec.europa.eu/eurostat).
- 13 European Commission. (2024). Slovenia 2024 Digital Decade Country Report. [Ec.europa.eu](https://ec.europa.eu/eurostat).
- 14 Strack, R., Kovács-Ondrejko, O., Baier, J., Kotsis, Á., Antebi, P., & Kavanagh, K. (2021). *Decoding the Digital Talent Challenge*. BCG.

- 15 Startup Genome. (2022). The Global Startup Ecosystem Report: GSER 2022. Startup Genome LLC.
- 16 European Commission. (2021). 2021 SME Country Fact Sheet: Albania. Ec.europa.eu.
- 17 European Commission. (n.d.). The Digital Economy and Society Index (DESI) | Shaping Europe's digital future. Digital-Strategy.ec.europa.eu.
- 18 Eurostat. (2024). Technology in candidate countries and potential candidates (digital transformation) - Statistics Explained. Ec.europa.eu.
- 19 World Bank. (2023). Rural population growth (annual %) - Albania. The World Bank Group.
- 20 INSTAT. (2023). Bilanci i Energjisë Elektrike.
- 21 World Bank. (2023). Manufacturing, value added (% of GDP) - Albania. The World Bank Group.
- 22 Irascu, D. (2023). The Albanian ICT Industry: Data & Insights. Tech Behemoths.
- 23 Lena, O., & Marketing, D. B. (2022). Tourism and Hospitality in Albania 2022. UNDP.
- 24 United Nations. (2023). Sustainable blue economy vital for small countries and coastal populations. UN News.
- 25 Eurostat. (2024). Resources and green transformation in candidate countries and potential candidates. Ec.europa.eu.
- 26 Bosma, N., Hill, S., Ionescu-Somers, A., Kelley, D., Levie, J., & Tarnawa, A. (2020). Global Entrepreneurship Monitor: 2019/2020 Global Report. The Global Entrepreneurship Research Association.
- 27 South Summit. (2018).
- 28 United Nations. (2019). World Population Ageing 2019 . The Population Division of the United Nations Department of Economic and Social Affairs (UN DESA).
- 29 INSTAT. (2022). Popullsia e Shqipërisë.
- 30 OECD. (2019). Getting skills right: Future-ready adult learning systems. OECD Publishing.
- 31 Stypióńska, J., Franke, A., & Myrczik, J. (2019). Senior entrepreneurship: The unrevealed driver for social innovation. Frontiers in Sociology, 4, 30.
- 32 OECD. (2019). Strengthening SMEs and entrepreneurship for productivity and inclusive growth: OECD 2018 Ministerial Conference on SMEs. OECD Studies on SMEs and Entrepreneurship. OECD Publishing.
- 33 Isele, E. (2019). Empowering Experience to Boost Prosperity for All Ages. Global Institute for Experienced Entrepreneurship | United Nations.
- 34 Chesbrough, H. (2004). Managing open innovation. Research-technology management, 47(1), 23-26.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTËR SHTETI PËR
SIPËRMARRJEN DHE
KLIMËN E BIZNESIT

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024 – 2030

Tiranë, Dhjetor 2024